



**Grupi për
Politika
dhe Avokim
KOSOVË-SERBI**

MARRËVESHJET E DIALOGUT TEKNIK KOSOVË - SERBI: PËRSHTYPJET NË TERREN

**Prishtinë,
Mitrovicë e Veriut,
Beograd
SHKURT 2020**



Funded by
the European Union





**Grupi për
Politika
dhe Avokim
KOSOVË-SERBI**

MARRËVESHJET E DIALOGUT TEKNIK KOSOVË - SERBI: PËRSHTYPJET NË TERREN

Prishtinë, Mitrovicë e Veriut, Beograd
Shkurt 2020



Funded by
the European Union

Organizatat bashkëpunuese nëstudim

NGO Aktiv, Mitrovicë
office@ngoaktiv.org

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS), Prishtinë
info@qkss.org

Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë (BCSP), Beograd
office@bezbednost.org

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me asistencë financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Grupit për Politika dhe Avokim Kosovë-Serbi dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

TABELA E PËRMBAJTJES

04	LISTA E SHKURTESAVE
05	1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
06	2. HYRJE
06	2.1. Informacione të përgjithshme
07	2.2. Studimi i KSPAG
08	3. METODOLOGJIA DHE MOSTRAT
08	3.1. Fokus-grupet
10	3.2. Intervistat
10	3.3. Anketimet online
11	4. NJOHURITË THEMELORE TË PJESËMARRËSVE PËR PROCESIN E DIALOGUT
11	4.1. Shkaqet kryesore që ndikuan në informimin e respondentëve për marrëveshjet teknike
11	4.2. Shkaqet kryesore që ndikuan në mosinformimin e respondentëve për marrëveshjet teknike
12	4.3. Njohuritë për marrëveshjet specifike
35	4.4. Paraqitja grafike e nivelit të njohurive për marrëveshjet teknike
37	5. PËRSHTYPJET E PJESËMARRËSVE LIDHUR ME TË ARDHMEN E DIALOGUT
38	6. PËRFUNDIME TË PËRGJITHSHME
39	7. TË GJETURAT KRYESORE NGA RAPORTI
40	8. REKOMANDIMET
42	SHTOJCAT

LISTA E SHKURTESAVE

A/KSS	Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe
AKKVP	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
BCSP	Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë
BE	Bashkimi Evropian
BFPE	Forumi i Beogradit për Përsosmëri Politike
BPRG	Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan
D4D	Demokraci për Zhvillim
EAU	(ang: European Association of Universities), Asociacioni i Universiteteve Evropiane.
EMinS	Lëvizja Evropiane në Serbi
IBM	(ang: Integrated Boundary/Boarder Management), Menaxhimi i Integruar i Kufirit
KCSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
KSPAG	Grupi për Politika dhe Avokim Kosovë-Serbi
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
ROSU	(ang: Regional Operational Support Unit of Kosovo Police), Njësia Rajonale për Mbështetje Operative e Policisë së Kosovës
YUCOM	Komisioni i Juristëve për të Drejtat e Njeriut

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Dialogu Kosovë-Serbi, i ndërmjetësuar nga BE-ja ka përparuar mjaft. Pavarësisht vështirësive të shumta, procesi ka rezultuar me arritjen e pesëmbëdhjetë marrëveshjeve, të cilat mbulojnë një numër të fushave që për qëllim kanë të ndihmojnë normalizimin e marrëdhënies mes të dy palëve dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve. Megjithatë, implementimi i një pjese të madhe të këtyre marrëveshjeve po përballet me sfida të mëdha, kryesisht për shkak të mungesës së vullnetit politik. Përkundër kësaj, një pjesë e tyre kanë arritur një nivel të konsiderueshëm të implementimit, duke siguruar kështu përfitime konkrete për qytetarët.

Procesi i përgjithshëm i dialogut teknik është përcjellë me mungesë transparence nga të dy qeveritë, gjë që ka ndikuar në informimin e kufizuar të qytetarëve për procesin dhe rezultatet e tij. Studimi i realizuar nga anëtarët e Grupit për Politika dhe Avokim Kosovë-Serbi (KSPAG), Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS), OJQ AKTIV dhe Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë (BCSP) kanë bërë një hulumtim të përshtypjeve dhe përvojave personale të shqiptarëve të Kosovës, serbëve të Kosovës dhe të shtetasve të Serbisë lidhur me dialogun teknik.

Gjetjet tregojnë se implementimi i përgjithshëm i të gjitha marrëveshjeve teknike është vlerësuar negativisht nga shumica e grupeve të trajtuara, në ndërkohë që respondentët janë shfaqur skeptikë edhe për sa i përket përfitimeve nga implementimi i marrëveshjeve. Njohuritë e përgjithshme të respondentëve rreth marrëveshjeve teknike janë të një niveli mesatar. Gjeneratat më të moshuara (31+) u treguan përgjithësisht më të informuara rreth implementimit të marrëveshjeve teknike, krahasuar me pjesëtarët e gjeneratave më të reja. Shumica e respondentëve besojnë se dialogu i deritanishëm nuk ka sjellë ndonjë dobi për qytetarët. Një pjesë e tyre besojnë se disa gjëra janë përmirësuar (liria e lëvizjes, telekomunikacioni,

etj.), ndonëse e pranojnë se përparimet në fjalë janë pothuajse të parëndësishme.

Rekomandimet që dalin nga përgjigjet e mbledhura në këtë studim flasin për domosdoshmërinë e rritjes së përpjekjeve të palëve të interesit për një informim të plotë mbi rezultatet e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja, si dhe rreth implementimit të marrëveshjeve që dalin nga ai, për të rritur kështu transparencën e procesit dhe për të parandaluar manipulimet politike gjatë procesit. Bashkimi Evropian, si ndërmjetësues i dialogut, duhet të posedojë një mekanizëm më të mirë të detyrimit të qeverisë së Serbisë dhe të Kosovës për të siguruar një implementim transparent dhe adekuat të marrëveshjeve ekzistuese teknike.

Gjithashtu, është rekomanduar një rishikim i marrëveshjeve të pa implementuara teknike, krahas përfshirjes së ekspertëve dhe angazhimit të popullatës lokale në vetë procesin e implementimit. Është theksuar, po ashtu, edhe rritja e rolit të mediave në monitorimin e procesit të implementimit dhe në informimin e publikut për rezultatet e dialogut. Në këtë mënyrë do të fitonim një narrativë të re—e cila do të përqendrohej në problemet dhe interesat e përbashkëta me të cilat preokupohen serbët dhe shqiptarët etnikë.

Raporti fillon me informacione të përgjithshme që ndërliken me kontekstin, dhe vazhdon me prezantimin e metodologjisë së studimit dhe të mostrave. Raporti tutje paraqet një përmbledhje të asaj se si respondentët i kuptojnë marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut teknik dhe përshtypjet e tyre rreth të ardhmes së procesit. Gjetjet nga studimi janë të përmbledhura në pjesën përfundimeve, dhe ato janë përkthyer si rekomandime konkrete për palët e interesuara që aktualisht janë të përfshira në dialogun teknik mes Prishtinës dhe Beogradit, ose që do të jenë të përfshira në të ardhmen.

2. HYRJE

2.1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja, të cilit shpeshherë i referohen edhe si dialogu i Brukselit ndërmjet Prishtinës e Beogradit, zyrtarisht filloi në fillim të vitit 2011, menjëherë pas prezantimit të Rezolutës nr. 64/298 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Përfaqësuesit e Kosovës dhe Serbisë zhvilluan takime zyrtare në periudhën mes marsit 2011 dhe korrikut 2012, kur negociatorët e emëruar për çështje teknike i diskutuan çështjet kryesore që rëndonin mbi qytetarët e Kosovës dhe të Serbisë. Për shkak të natyrës së tij dhe çështjeve që i mbulon, gjithë procesi u dizajnuar si një *dialog teknik*, nga i cili do të rezultonin *marrëveshje teknike*.

Që nga vera e vitit 2012 takimet u ngritën në një nivel më të lartë përfaqësimi, ngase në dialog morën pjesë edhe kryeministri i Kosovës dhe ai i Serbisë, edhe pse negociatat vazhduan edhe në nivel teknik. Kjo, për shkak të nevojës së trajtimit të problemeve të përditshme të cilat i hasnin njerëzit e zakonshëm, si pasojë e raporteve të padefinuara juridike, ekonomike dhe të komunikimit ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës.

Me ndërmjetësimin e Përfaqësuesit të Lartë për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë të Bashkimit Evropian, të dy palët arritën të

negociojnë çështje tejet të rëndësishme për qytetarët e Kosovës dhe Serbisë, dhe pastaj filluan me implementimin e marrëveshjeve të nënshkuara. Vetë dialogu ndërkaq fitoi në rëndësi pas prezantimit në vitin 2013 të *Marrëveshjes së Parë mbi Parimet e Qeverisjes për Normalizimin e Marrëdhënieve*, e njohur si Marrëveshja e Brukselit, dhe si pasojë e integritit të katër komunave veriore në sistemin qeverisës të Kosovës.

Pas Marrëveshjes së Brukselit u nënshkruan edhe marrëveshje të tjera, me qëllim të lehtësimit të vështirësive të cilat ishin ende të pranishme. Implementimi i marrëveshjeve hasi në ngecje të vazhdueshme, të shkaktuara nga paqëndrueshmëritë politike në Kosovë dhe Serbi, por pengesat nga periudha e gjatë e para-negotiatave dhe vonesat në trajtimin e problemeve të pazgjadhura duket se janë eliminuar pjesërisht. Proces, i ndërmjetësuar nga BE-ja, i normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, nga palët ndërkombëtare të interesit është cilësuar si një proces i rëndësishëm për krijimin e paqes, rrjedhimisht, edhe procesit të implementimit të marrëveshjeve teknike i është kushtuar një vëmendje e veçantë.

Gjatë dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit janë arritur dhe nënshkruar marrëveshjet për çështje teknike të cekura në vazhdim, të cilat mbulojnë fusha të ndryshme me interes për popullatën lokale:

Liria e lëvizjes, 2 korrik 2011

- *Librat e gjendjes civile, 2 korrik 2011*
- *Kadastra, 2 korrik 2011*
- *Pranimi i diplomave universitare, 2 korrik 2011*
- *Vulat doganore, 2 shtator 2011*
- *Menaxhimi i integruar i kufirit/vijës kufitare, 23 shkurt 2012*
- *Përfaqësimi dhe bashkëpunimi rajonal, 24 shkurt 2012*
- *Energjia, 8 shtator 2013*
- *Telekomunikacioni, 3 shtator 2013*
- *Sigurimi i automjeteve, 25 qershor 2015*
- *Ura e Mitrovicës, 25 gusht 2015.*
- *Marrëveshja e Parë mbi Parimet e Qeverisjes për Normalizimin e Marrëdhënieve, 19prill 2013, që mbulon çështjet e:*
 - *Integritit të gjyqësorit në katër komunat veriore të Kosovës;*
 - *oIntegritit të zbatimit të ligjit në katër komunat veriore të Kosovës;*
 - *oIntegritit brenda institucioneve të Kosovës të pjesëtarëve të Njësisë të Mbrojtjes Civile;*
 - *oThemelimit të asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe;*

Procesi i implementimit të marrëveshjeve së lartpërmendura është në vazhdim e sipër, edhe pse po përballet me pengesa. Në kohën e realizimit të këtij studimi, dialogu ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës po përballej ende me një periudhë ngecjeje, megjithëse, përkundër kësaj implementimi i marrëveshjeve nuk ishte ndalur.

2.2. STUDIMI I KSPAG

Në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian: “*Promovimi dhe Komunikimi i Përfitimeve nga Dialogu Kosovë-Serbi, i Ndërmjetësuar nga BE-ja*”, anëtarët e Grupit për Politika dhe Avokim Kosovë-Serbi (KSPAG): Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS), OJQ Aktiv dhe Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë (BCSP), kanë kryer një studim që për qëllim pati analizimin e përshtypjeve dhe përvojave personale të qytetarëve për dialogun teknik dhe rezultatet e tij.

Me shqiptarët e Kosovës ky studim është kryer në pesë komuna të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë e Jugut, Gjilan, Pejë, dhe Prizren; me serbët e Kosovës: në pesë komuna të tjera të Kosovës: Mitrovicë e Veriut, Graçanicë, Shtërpçë, Shillovë, Gorazhdec; dhe me serbët dhe shqiptarët e Serbisë në tetë komuna të Serbisë: Kragujevc, Kraljevë, Novi Pazar, Beograd, Novi Sad, Vrajë, Bujanoc dhe Nish.

Raporti është bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë hulumtimeve në terren, brenda periudhës korrik-tetor 2019. Pjesë e këtij studimi ishin gjithsejtë 360 responentë.


3. METODOLOGJIA DHE MOSTRAT

Të tri organizatat aplikuan metodologji të ngjashme të hulumtimit, të cilat lejojnë krahasimin e qëndrimeve dhe të përshtypjeve të: (1) shqiptarëve të Kosovës, (2) serbëve të Kosovës, dhe (3) serbëve dhe shqiptarëve të Serbisë. Gjithsejtë janë organizuar 36 fokus-grupe dhe janë kryer 11 intervista dhe 2 anketime online. Mbledhja e të dhënave është bazuar në pyetësor. Pyetësorët e hulumtimit janë të qasshëm në fund të këtij raporti, në formë shtojcash. Përmbajtja e pyetësorëve ishte e njëjtë për të tri metodat e mbledhjes së të dhënave, dhe që të tri organizatat partnere aplikuan pyetësorë të njëjtë gjatë mbledhjes së të dhënave. Pyetësorët janë adaptuar për kontekstet lokale dhe për metodat e mbledhjes së të dhënave.

Respodentëve iu është ofruar një prezantim me informata për projektin, qëllimet dhe financuesit e tij, si dhe për konsorciumin e organizatave implementuese. Respodentët janë njoftuar edhe për qëllimin e përdorimit të të dhënave dhe të gjetjeve nga studimi. Hulumtimi në terren përfshiu dy grupmosha: 18-30 vjet dhe 31-65 vjet, dhe ishte shumë i vëmendshëm ndaj përfaqësimit gjinor.



3.1. FOKUS-GRUPET

Tri organizatat partnere i shfrytëzuan fokus-grupet si metodë kryesore të studimit. Fokus-grupet përbëheshin nga qytetarë të zakonshëm nga zona të ndryshme gjeografike, por që ishin pjesë e të dy grupmoshave. Fokus-grupet e para përbëheshin nga respodentë të moshës mes 18 dhe 30-vjeçare, ndërkaq fokus-grupet e dyta nga respodentë mes moshës 31 dhe 65-vjeçare. Kjo ndarje kishte për qëllim identifikimin e pikëpamjeve të ndryshme mes dy grupmoshave. Respodentët u përzgjedhën në bazë të komponentit gjinor, nivelit të arsimimit dhe profesionit të tyre, dhe që të gjithëve iu ofrua opsioni i ruajtjes së anonimitetit. Lokacionet u përzgjedhën duke synuar një shtrirje sa më të gjerë gjeografike, me fokus në zonat që karakterizohen me tipare të dallueshme shoqërore, politike dhe kulturore. Anketimet zgjatën diku mes një orë deri në një orë e gjysmë për një seancë të fokus-grupit. KCSS realizoi dhjetë fokus-grupe, që përbëheshin nga shqiptarët e Kosovës nga pesë rajone të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë e Jugut, Gjilan, Pejë dhe Prizren.



¹ Respondents were not explicitly asked about their ethnicity.


KCSS realizoi dhjetë fokus-grupe, që përbëheshin nga shqiptarët e Kosovës nga pesë rajone të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë e Jugut, Gjilan, Pejë dhe Prizren.



- BCSP realizoi fokus-grupet në tetë qytete nëpër gjithë Serbinë: Kragujevc, Kralejë, Novi Pazar, Beograd, Novi Sad, Vrajë, Bujanoc dhe Nish. Këto lokacione u përzgjedhën me qëllim që të sigurohej një përfaqësim i rajoneve të ndryshme gjeografike, dhe i pakicave kombëtare – i boshnjakëve nga Sanxhaku, dhe i shqiptarëve nga Lugina e Preshevës, por edhe i qyteteve me një numër të konsiderueshëm të serbëve të zhvendosur nga Kosova. Një numër i madh i respondentëve brenda fokus-grupeve ishin me origjinë nga,

apo kishin lidhje të afërta me Kosovën. Për sa i përket vizitave të tyre në Kosovë, respondentët mund të ndahen në disa kategori:

- oNë ata që nuk kanë qenë asnjëherë në Kosovë;
- oNë ata që në Kosovë kanë qenë para vitit 1999;
- oNë ata që kanë udhëtuar shpesh në Kosovë; dhe
- oNë ata që në Kosovë kanë qenë për turizëm, shkollim, aktivizëm, ose vetëm kanë kaluar nëpërmjet saj.



3.2. INTERVISTAT

Me qëllim të mbledhjes së të dhënave janë kryer edhe intervista:

- KCSS ka kryer një numër intervistash me qëllim të mbulimit të zbrazësive në të dhënat e hulumtimit;
- OJQ Aktiv nuk ka kryer fare intervista;
- BCSP ka kryer intervista me ekspertë, aktivistë të shoqërisë civile dhe me gazetarë të pavarur. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar përzgjedhjes së Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) dhe bizneseve lokale, me qëllim të sigurimit të qëndrimeve dhe përvojave më të detajuara rreth bashkëpunimit me Kosovën.

3.3. ANKETIMET ONLINE

Mbledhja e të dhënave online është administruar nga KCSS-ja dhe nga OJQ Aktiv, me qëllim që studimi të plotësohet me të dhëna shtesë, përpos atyre të mbledhura përmes fokus-grupeve dhe/ose intervistave. Anketimi online përbëhet nga pyetje të mbyllura dhe të hapura, të cilat në fokus kishin marrëveshjet më të rëndësishme teknike. Organizatat partnere që e aplikuan këtë komponent u pajtuan se ishte e domosdoshme që të kryhej një anketim i njëjtë me ekspertë që kanë interesim të madh për këtë temë dhe me opinionistët që kanë rol kyç në formimin e opinionit publik për këtë proces. Rrjedhimisht, anketimi përfshiu anëtarët aktivë të OShC-ve, anëtarët e organizatave të grave, sektorin e biznesit, përfaqësuesit e komuniteteve lokale, përfaqësuesit e mediave dhe pjesëtarët e organizatave rinore me prejardhje të ndryshme. Struktura e moshës së grupit të përfshirë në anketim nuk kishte ndonjë relevantë për vetë anketimin, meqenëse qëllimi i tij ishte pasqyrimi i zgjeruar i pikëpamjeve të personave që janë pjesë e grupeve specifike sociale ose ekonomike. Edhe anketimi online ishte anonim, prandaj nuk u mblodhën të dhëna për gjininë, moshën apo prejardhjen etnike të pjesëmarrësve në këtë pjesë të studimit. Pjesëmarrësit shfaqën njohuri të ndryshme për marrëveshjet e arritura gjatë dialogut në Bruksel. Më poshtë mund të gjinden shkaqet kryesore se pse të anketuarit janë të informuar, ose pse nuk janë.

4. NJOHURITË THEMELORE TË PJESËMARRËSVE PËR PROCESIN E DIALOGUT

4.1. SHKAQET KRYESORE QË NDIKUAN NË INFORMIMIN E RESPUDENTËVE PËR MARRËVESHJET TEKNIKE

Për shumicën e shqiptarëve të Kosovës, shkakut kryesor pse ata posedojnë informacione për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është se procesi ka pasur një vëmendje të jashtëzakonshme të mediave. Respondentët deklaruan se i ndjekin me vëmendje raportet dhe diskutimet në media që kanë lidhje me dialogun; si në edicionet lokale të lajmeve, në debatet televizive dhe në artikuj gazetash. Madje, disa prej respondentëve shqiptarë të Kosovës treguan se i përcjellin edhe lajmet e kanaleve televizive serbe, për të kuptuar se çfarë prezantojnë ata në mediat e tyre. Pjesa më e madhe e pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë besojnë se informacionet bazike për dialogun

mes Kosovës dhe Serbisë ishin të pranishme në shumicën e mediave në gjuhën serbe. Tutje, respondentët nga ky komunitet pohuan se fushat e marrëveshjeve teknike të implementuara janë të një rëndësie jetike për komunitetin serb që jeton në Kosovë. Respondentët nga Serbia ndërkaq pohuan se lajmet i ndjekin me vëmendje, me qëllim që të mësojnë më tepër rreth dialogut në Bruksel. Megjithatë, sipas tyre, nuk është gjithnjë e mundur që të merren informacione të qarta e të sakta. Disa prej respondentëve thanë se informohen nga miqtë, ose nga të afërmit e tyre që jetojnë në Kosovë, edhe pse njohuritë e tyre për dialogun e Brukselit zakonisht janë të pjesshme (vetëm mbi çështjet e caktuara), e nganjëherë edhe të njëanshme, sepse bazohen vetëm në përgjithësim të rasteve ose përvojave individuale. Më të informuarit janë gazetarët dhe aktivistët e OJQ-ve, të cilët vazhdimisht kërkojnë informacione dhe të njëjtat i sigurojnë jashtë mediave kryesore, derisa e kryejnë punën e tyre.

“Edhe pse po përpiqem, pothuajse asgjë nga kjo që po ndodhë nuk është plotësisht e qartë për mua. Më herët isha në gjendje të kuptoja se çka është nënshkruar, por së fundmi është bërë aq konfuze sa që nuk dihet më se kush çka nënshkroi.” (Grua, 31, Beograd)



4.2. SHKAQET KRYESORE QË NDIKUAN NË MOSINFORMIMIN E RESPUDENTËVE PËR MARRËVESHJET TEKNIKE

Si arsye kryesore për mungesën e informacioneve për marrëveshjet respondentët shqiptarë të Kosovës e konsiderojnë mos transparencën e procesit të dialogut. Edhe serbët e Kosovës mendojnë se informacionet e kufizuara që i posedojnë për marrëveshjet teknike janë rezultat i adresimeve jotransparente nga ana e qeverive përkatëse lidhur me procesin e implementimit të marrëveshjeve teknike, dhe e mungesës së

burimeve online që do të ishin në dispozicion të publikut, lidhur me të gjitha marrëveshjet teknike (të përmbledhura në një vend) - veçanërisht në gjuhën serbe. Bazuar në gjetjet nga ky studim del se, për sa i përket informimit të duhur dhe të drejtë rreth Dialogut të Brukselit njerëzve në Serbi iu mungon besimi në media, por edhe në politikanë. Pjesa më e madhe e tyre besojnë se informacionet po bllokohen qëllimisht, ose po mbahen të fshehta nga qytetarët. Një numër i konsiderueshëm i respondentëve nga të gjitha grupet e përfshira etnike, veçanërisht nga ata më të rinj në moshë, deklaruan se kanë humbur (ose po e humbin) interesimin për Dialogun e Brukselit, meqenëse “është zgjatur së tepërmi.”

“Është e domosdoshme që Dialogu i Brukselit ‘të përkthehet’ - nga gjuha e Brukselit në gjuhën e zakonshme; dhe që njerëzve t’iu tregohet se çfarë do të thotë Dialogu dhe çfarë do të sjellë ai për ta.” (Grua, 37, Nish)



4.3. NJOHURITË PËR MARRËVESHJET SPECIFIKE

MARRËVESHJA PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË KUFIRIT/VIJËS KUFITARE


Marrëveshja për Menaxhimin e Integruar të Kufirit/Vijës Kufitare (IBM) është arritur më 2 dhjetor 2011, dhe me qëllim të implementimit të saj, dy muaj më vonë (më 24 shkurt 2012) janë vendosur edhe inicialet në Protokollin Teknik. Marrëveshja e përcakton bashkëpunimin e dy palëve për menaxhimin e pikë-kalimeve kufitare, me një prani të ekuilibruar të policisë dhe personelit doganor. Ajo lejon zbatimin e detyrimeve dhe përgjegjësiwe juridike nga të dy palët, duke u bazuar në juridiksionet e tyre. Si e tillë, marrëveshja ka shënuar një nivel të suksesshëm të implementimit. Shumica e *respodentëve shqiptarë të Kosovës* pohuan se për marrëveshjen e IBM-it kishin dëgjuar në lajme por nuk ishin të informuar nëse marrëveshja po implementohej. Madje, edhe ata që kishin udhëtuar për në Serbi nuk ishin të sigurt në këtë gjë, meqenëse edhe pse i kishin parë ndërtesat e përbashkëta, nuk e kishin ditur nëse ato funksiononin si të tilla. *Respodentët serbë nga Kosova* kanë treguar përvoja personale (neutrale) të llojllojshme për pikë-kalimet e integruara kufitare. Mirëpo, shumica e tyre kanë kritikuar kontrollin shpeshherë të detajuar dhe të gjata nëpër pikat kufitare, duke nënvizuar se ekziston një trendi për trajtim selektiv të personave që kalojnë nga Kosova në Serbi, dhe anasjelltas. Një pjesë e konsiderueshme e tyre theksuan se ekziston një rritje e ndjeshme e diskriminimit të njerëzve që posedojnë dokumente personale të lëshuara nga Drejtoria Serbe për Koordinim, por edhe e atyre që posedojnë dokumente shtetërore serbe, të lëshuara në Serbi. Po ashtu, ata kanë theksuar se bllokimi i komunikacionit është bërë një dukuri pothuajse e zakonshme në shumicën e pikë-kalimeve kufitare. Problemi i fundit, ai i të

ashtuquajturave “masa reciproke” të Doganës së Kosovës, të cilat lidhen me çështjen e njohjes së pasaportave të lëshuar nga Serbia (dhe me pavlefshmërinë e tyre në pjesën e pikë-kalimeve të Kosovës) është përmendur po ashtu si shembull i interpretimit selektiv të ligjeve të Kosovës, gjë që nuk do të duhej të ndodhte në të ardhmen. Shumica e respodentëve nga Serbia kishin dëgjuar për marrëveshjen e IBM-it, megjithëse shumica e atyre që udhëtonin në Kosovë nënvizuan se ata kishin përshtypjen që pikë-kalimet kufitare nuk janë të integruara.

MARRËVESHJA PËR PËRFAQËSIM DHE BASHKËPUNIM RAJONAL

Marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për Përfaqësim dhe Bashkëpunim Rajonal është arritur më 24 shkurt 2012. Ajo i mundëson Kosovës të marrë pjesë dhe të përfaqësohet në iniciativat dhe organizatat rajonale me përdorimin e një ylli, pra, si “Kosova*”, gjë që nënkupton se “ky definim nuk e prejjudikon gjendjen e status quo-së, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës.” Sipas respodentëve shqiptarë të Kosovës, marrëveshja për përfaqësim rajonal dhe bashkëpunim në nismat rajonale që kanë të bëjnë me tregtinë, migrimin, etj, e ka dëmtuar drejtpërsëdrejti shtetësinë e Kosovës. Ata theksuan se kjo marrëveshje ishte iniciuar si një marrëveshje teknike e dalë nga dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja, mirëpo ajo tashmë po e prekë drejtpërsëdrejti shtetësinë e Kosovës, në ndërkohë që Serbia po vazhdon me dëmtimin dhe bllokimin e anëtarësimit dhe pjesëmarrjes së Kosovës nëpër nismat dhe organizatat ndërkombëtare, duke mos e zbatuar kështu fare këtë marrëveshje.

“Kjo është marrëveshja që e ka dëmtuar më së shumti Kosovën. Tejet e dhimbshme!” (Burrë, 50-vjeçar, Pejë)



Responentët serbë nga Kosova janë shprehur pothuajse njëzëri se nuk kanë njohuri për Marrëveshjen për Përfaqësimin dhe Bashkëpunim Rajonal, edhe pse një numër i vogël i tyre e dinin se Serbia është pajtuar që të mos ndërhyjë në rrugën e Kosovës drejt BE-së, nëse Kosova në nivel rajonal përfaqësohet me fusnotë (Kosova*).

Pjesa më e madhe e **responentëve nga Serbia** nuk e njihnin këtë Marrëveshje - me emrin e saj zyrtar, mirëpo më shumë se gjysma kishin dëgjuar për ‘yllin’ (fusnotën), megjithëse vetëm disa nga ata e dinin se cili ishte kuptimi i fusnotës. Sa i përket përfaqësimit rajonal të Kosovës, shumica mendonin se ylli është i pakuptimtë –ose, me fjalë të tjera, fakti që Kosova merr pjesë në forumet rajonale nënkupton që Serbia de facto e ka pranuar shtetësinë e saj.

“Kjo marrëveshje e nënkupton njohjen. Për shumicën e qytetarëve emri nuk do të thotë asgjë. Çështja pra që duhet shtruar këtu është nëse ai shtet ekziston, nëse merr pjesë në institucionet ndërkombëtare – kjo është esenca.” (Burrë, 29, Kragujevc)



Për dallim, disa prej pjesëmarrësve besonin se ylli e mbron pozicionin e Qeverisë së Serbisë.

“Ylli paraqet një gjë të rëndësishme. Ai tregon se nuk e kemi njohur Kosovën. Pra, kjo është një çështje nderi.” (Grua, 57, Beograd)



Pjesa tjetër e pjesëmarrësve përbëhej nga ata që mendonin se Kosova duhet të përfaqësohet nëpër forumet rajonale, dhe nga ata që nuk pajtoheshin me këtë gjë.

Kosova nuk duhet të marrë pjesë. Si qytetar i Serbisë e kam për detyrë ta respektoj Kushtetutën, dhe ajo thotë se Kosova është pjesë e Serbisë.” (Burrë, 29, Kragujevc)



“Edhe pse Serbia e ka nënshkruar marrëveshjen, ajo nuk po e implementon atë. Ajo po e pengon implementimin e saj.” (Burrë, 30+, Bujanoc)



Nga ana tjetër, për komunitetin shqiptar që jeton në Serbi asocimi i tyre i parë që lidhet me këtë marrëveshje është se Serbia po e pengon pjesëmarrjen e Kosovës në organizatat

dhe nismat ndërkombëtare. Sipas tyre, kjo Marrëveshje nuk i kontribuon në asnjë mënyrë mirëqenies së qytetarëve.

“Edhe pse Serbia e ka nënshkruar marrëveshjen, ajo nuk po e implementon atë. Ajo po e pengon implementimin e saj.” (Male, 30+, Bujanovac)



LIRIA E LËVIZJES

Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes është arritur më 2 korrik 2011, ndërsa implementimi i saj praktik ka filluar më 26 shtator 2011. Marrëveshja synon normalizimin e lëvizjes së lirë të njerëzve mes Kosovës dhe Serbisë, duke përdorur dokumentet zyrtare të të dy palëve, përfshirë këtu patentë shoferët dhe targat e automjeteve. Marrëveshja lejon që qytetarët që jetojnë në Kosovë dhe Serbi të lëvizin lirshëm brenda dy territoreve përkatëse. Ajo kërkon që vija kufitare administrative të kalohet me përdorimin e letërnjoftimeve, me qëllim të shmangies së përdorimit të pasaportave dhe që në këtë mënyrë të mundësohet lëvizja

e qytetarëve pa një adresim të drejtpërdrejtë të statusit të Kosovës. Një marrëveshje shtesë është bërë edhe njohja e ndërsjellë e sigurimit të automjeteve. **Respodentët shqiptarë të Kosovës** janë të vetëdijshëm se mund të udhëtojnë në Serbi vetëm me letërnjoftime. Shumica e tyre theksuan se para kësaj marrëveshje ata nuk mund të udhëtonin fare në Serbi, apo nëpërmjet Serbisë, gjë që ishte mjaft e dëmshme për ta. Ata vazhdimisht nënvizonin se nuk ekziston asnjë problem individual mes njerëzve në Kosovë dhe Serbi. Disa madje e përmendën se këtë marrëveshje e përdorën që të udhëtojnë në Serbi përtëtakuar miqtë e dikurshëm, që tani jetojnë atje.

“Tani udhëtojmë lirshëm për në Serbi. Kur vitin e kaluar shkova në Beograd, e takova mikun tim të vjetër, Stefanin, i cili dikur jetonte në Prizren.” (Burrë, 35, Prizren)



Sipas tyre, elitat politike dhe mediat janë ato që përhapin propagandë rreth situatës së përgjithshme. Megjithatë, nga respodentët u tha shumëherë se megjithëse marrëveshja në letër duket e shkëlqyeshme, qytetarët ende nuk ndihen të sigurtë që të udhëtojnë në Serbi. Kur u pyetën se prej nga buron kjo pasiguri, respodentët i përmendën incidentet e ndryshme të cilat kanë ulur besimin e qytetarëve se mund të udhëtojnë pa probleme. Një numër i madh i respodentëve pohuan se falë kësaj marrëveshje kanë udhëtuar për në Serbi. Ekzistojnë arsye të ndryshme përse shqiptarët e Kosovës udhëtojnë

në Serbi. Ishte evidente se tregtia, çështjet e ndryshme shëndetësore dhe vizitat kulturore ishin shkaqet kryesore për vizita të tilla. Për ata, udhëtimet në Serbi tashmë janë bërë të njëjta sikurse ato për në Mal të Zi apo Maqedoni.

Nga ana tjetër, respodentët kishin fare pak përvojë udhëtimi nëpër komunat e Kosovës me shumicë serbe. U nënvizua se për dallim nga qytetarët serbë të Kosovës, shqiptarët e Kosovës e kanë pothuajse të pamundur që ta vizitojnë veriun e Kosovës, meqenëse ajo pjesë e vendit është tejet e pasigurt për ata.

“Më sigurt është të udhëtohet në Serbi se sa në veri të Kosovës, meqenëse Qeverisë së Kosovës i mungon qasja në atë pjesë të territorit, sepse situata atje është tejet e brishtë.” (Burrë, 58, Gjilan)



Në këtë kontekst, edhe qasja e Bashkimit Evropian është kritikuar mjaft.

“Fakti që shtetasit e Serbisë mund të lëvizin lirshëm me targat e tyre të automjeteve, ndërkaq qytetarëve të Kosovës iu duhet t’i ndërrojnë ato sa herë që hyjnë në Serbi është tejet i padrejtë, dhe kjo gjë dëshmon se sa e njëanshme është BE-ja.” (Grua, 47, Mitrovicë e Jugut)



Shumë prej respondentëve këtë marrëveshje e shihnin si të dëmshme për identitetin kosovar. Respondentë nga komuna të ndryshme konsideronin se kalimi i kufirit vetëm me tregimin e “letërnjoftimit” është çështje mjaft problematike. Për shumicën e tyre, marrja e “letërnjoftimit serb” në një letër të formatit A4, të shkruar vetëm në alfabet cirilik, ua cenon drejtpërsëdrejti identitetin e tyre kombëtar. Ngjashëm, për një pjesë të respondentëve kjo marrëveshje nuk ka fare të bëjë me një marrëveshje për liri të lëvizjes, meqë ata nuk mund të kalojnë kufirin me pasaportën e tyre shtetërore, ngase Serbia nuk ua njeh shtetin.

Sipas *respondentëve serbë nga Kosova*, sa i përket përmirësimit të lirisë së lëvizjes është bërë një hap i madh përpara, dhe kjo si rezultat i implementimit të Marrëveshjes. Megjithatë, pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë ende ndjehen të izoluar, për shkak të trajtimit selektiv dhe ndonjëherë edhe diskriminimit institucional gjatë procesit të lëshimit të dokumenteve të identifikimit. Thënë ndryshe, respondentët që jetojnë në jug të lumit Ibër pohuan se janë përshtatur me rrethanat e reja, megjithëse ende përballesh me faktin se dokumentet e lëshuara nga Drejtoria Serbe për Koordinim nuk konsiderohen të vlefshme, e nga ana tjetër hasin në pengesa gjatë marrjes së letërnjoftimeve të Kosovës. Si rrjedhojë, një pjesë e madhe e pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë që jetojnë nëpër të ashtuquajturat

enklava, ndihen të izoluar dhe të diskriminuar nga institucionet publike. Të dhënat e këtij studimi tregojnë se 87.6% e respondentëve nuk kishin udhëtuar më shpesh në Serbi edhe pas arritjes së Marrëveshjes për Lirinë e Lëvizjes.

Megjithëkëtë, respondentët e konsideronin Marrëveshjen për Lirinë e Lëvizjes si shembull të një marrëveshjeje të implementuar relativisht mirë, për shkak se ajo ka zgjidhur, të paktën pjesërisht, një dimension tejet të rëndësishëm të jetës së komunitetit – atë të lirisë së udhëtimit dhe të lëvizjes brenda dhe jashtë Kosovës.

Vështirësi kryesore për implementimin e kësaj marrëveshjeje, siç u cek nga shumë respondentë, janë dispozitat problematike të saj për qytetarët e Kosovës, si p.sh. pamundësia e tyre që në Serbi të udhëtojnë me pasaporta të lëshuara nga Kosova, lëshimi i dokumenteve të përkohshme nga Serbia nëpër pikëkalimet kufitare (si një mjet për mosnjohje të dokumenteve të lëshuara nga Kosova), dhe kërkesa për mbulimin e targave të automjeteve.

Shumica e respondentëve serbë nga Kosova kishin informata për rregullat e targave të automjeteve, ngase shumë prej tyre kishin pasur rastin të kalonin kufirin mes Kosovës dhe Serbisë. Në këtë kuptim, ata i vlerësuan si pozitive masat rregulluese që janë pjesë e procesit të implementimit, por edhe numëruan një sërë problemesh në të cilat kanë hasur vetë ata.

Një prej çështjeve kryesore që u përmend nga responentët ishte procedura e paqartë dhe shpeshherë e komplikuar administrative e marrjes së targave të Kosovës 'RKS'. Në të vërtetë, sikurse u përmend nga responentët, ka pasur raste kur nuk ka qenë e mundur që të bëhej ri-regjistrimi i automjeteve me targa të lëshuara nga Serbia apo me ato KS (të lëshuara nga UNMIK-u) në ato të Kosovës (RKS). Siç u theksua nga disa responentë, kjo gjë zakonisht ndodhë për shkak të paqartësive ligjore, por edhe për shkak të qëndrimit oportunist ose interpretimit individual të ligjit nga ana e zyrtarëve publikë. Për më tepër, shumë prej tyre u ankuan në çmimet e larta të procedurave të ri-regjistrimit, si dhe në kostot e larta të tarifave të aplikuar në pikë-kalimet e integruara kufitare.

Responentët nga veriu i Kosovës ngritën çështjen e pazgjidhur të targave të lëshuara dikur nga Serbia, me emërtime të qyteteve të Kosovës (KM për Mitrovicën, PR për Prishtinën, GL për Gjilanin, PZ për Prizrenin, PE për Pejën, DJ për Gjakovën dhe UR për Ferizajn), të cilat (jozyrtarisht) lejohet të lëvizin vetëm brenda katër komunave veriore. Për këtë arsye, nga responentët u sugjerua që kjo zonë emjegullt, siç e cilësuan ata, të adresohet sa më shpejtë, ngase kjo situatë vetëm sa e zgjatë pamundësinë e lëvizjes për pronarët e automjeteve me targa të tilla. Disa nga responentët e kritikuan ashpër personelin që punon nëpër pikë-kalimet kufitare mes Kosovës dhe Serbisë, për shkak të tendencës së tyre për të kërkuar dokumente shtesë, të cilat ligjërisht nuk kërkohen kur të kalohet kufiri.

Ulja e shpenzimeve për sigurimin e automjeteve, si dhe njohja e tyre nga ana e Kosovës dhe e Serbisë u lavdëruan shumë nga shumica e responentëve (nga ata që posedonin automjete personale ose që kishin përvojë në këtë çështje). Disa responentë theksuan se shpenzimet për sigurimin e automjeteve të regjistruara me tabela RKS janë më të larta se sa ato për automjetet e regjistruara me tabela KS, gjë që do të duhej të rregullohej në mënyrë adekuate, respektivisht nëpërmjet uljes së shpenzimeve.

Disa prej responentëve e përmendën edhe prezantimin e Memorandumit të Mirëkuptimit lidhur me sigurimin e automjeteve, si një veprim të duhur për një lëvizje më dinamike dhe të lirë në lëmin e transportit. Po ashtu, u përmend se ekziston një hapësirë e konsiderueshme e manovrimit jo vetëm për rregullimin e sigurimit të automjeteve, por edhe të qasjes së përgjithshme për avancimin e lirisë së lëvizjes mes Kosovës dhe Serbisë.

Megjithëse shumica e *responentëve në Serbi* kishin dëgjuar për Marrëveshjen për Lirinë e Lëvizjes, ata nuk kishin njohuri për përmbajtjen e saj. Responentët kishin mendime të ndryshme rreth asaj nëse ka liri të lëvizjes në Kosovë, në Serbi, dhe mes Kosovës e Serbisë. Disa prej tyre-ata që kishin udhëtuar në Kosovë - folën rreth përvojave personale, ndërkohë që të tjerët folën rreth asaj që kishin dëgjuar nga njerëzit që i njihnin, ose nga mediat.

Një pjesë e responentëve besojnë se liria e lëvizjes respektohet plotësisht. Për shembull, një responent nga Kragujevci deklaroi se fqinji i tij udhëtonte në Kosovë me veturë me targa serbe – në komunat me shumicë serbe, por edhe në Prishtinë. Siç u tha nga responenti në fjalë, fqinji i tij asnjëherë nuk ka pasur asnjë problem. Edhe shumë responentë të tjerë, që ishin pjesë e pothuajse të gjitha fokus-grupeve, përmendën shembuj të ngjashëm. Shumica dërrmuese e atyre që udhëtojnë ose që udhëtuan në Kosovë sqaruan se kufirin e kalonin/kalojnë vetëm me letërnjoftime, dhe pa asnjë lloj problemi.

Sido që të jetë, disa prej responentëve përmendën edhe probleme specifike që lidhen me lirinë e lëvizjes - disa theksuan se kishin dëgjuar se autobusët nga Serbia nuk lejohen gjithnjë që të hyjnë brenda territorit të Kosovës, ndonjëherë edhe pa ndonjë arsye të veçantë; disa e përmendën se automjetet me targa serbe kanë nevojë për përcjellje të policisë brenda territorit të Kosovës, për të garantuar kështu sigurinë e tyre.

“Kam shokë, nacionalistë, të cilët i vizitojnë manastiret serbe në Kosovë. Ata thonë se kanë pasur përvoja negative, dhe se autobusi i tyre është sulmuar me gurë.” (Burrë, 22-vjeçar, Novi Sad)



Po ashtu, disa nga respondentët përmendën edhe atë se zyrtarët e Qeverisë së Serbisë kanë nevojë për leje për të hyrë në Kosovë –gjë të cilën ata e shohin si shkelje të lirisë së lëvizjes. Një respondentë me origjinë nga Kosova, që jeton

në Beograd, theksoi se për të kaluar kufirin asaj i duheshin dy letërnjoftime, një serb dhe një kosovar, sepse në letërnjoftimin e saj serb thuhet se vendbanim i saj është Kosova.

“Unë i tregoj të dy letërnjoftimet në kufi, atë serb palës serbe dhe atë kosovar në Kosovë.” (Grua, 45-vjeçare, Beograd)



Është indikative se disa prej respondentëve theksuan se vetëm serbët kanë probleme me lirinë e lëvizjes në Kosovë, përderisa qytetarët e Kosovës lëvizin lirshëm nëpër Serbi. Vetëm një pjesëmarrës (nga Kragujevci) përmendi rastin e një ngasësi të kamionit nga Kosova, i cili posedonte dokumente të Kosovës, përfshirë patentë shoferin, dhe i cili ishte ndalur nga policia në jug të Serbisë, dhe për këtë gjë në fund i ishte dashur të paguante gjobë. Nga ana tjetër, një respondent shqiptar që ishte pjesë e fokus-grupit në Bujanoc, deklaroi se ka familjarë në Kosovë, të cilët nuk i kishin vizituar më në Serbi, për shkak të procedurës tejet të ndërlikuar – shtetasit e Kosovës duhet të ndërrojnë targat e automjeteve në kufi, radhët nëpër pikë-kalime kufitare drejt Serbisë janë shumë herë më të gjata se sa ato që vijnë nga drejtimi i kundërt, atyre iu duhet të plotësojnë formularë, etj. Ai sqaroi se është shumë më lehtë për shtetasit e Serbisë që

të shkojnë në Kosovë, se sa anasjelltas. Po ashtu, disa respondentë të etnisë shqiptare theksuan se shqiptarët e Kosovës kanë frikë të shkojnë në Serbi, dhe se edhe ata vetë – shqiptarët nga Lugina e Preshevës –hezitojnë të flasin shqip nëpër qytetet me shumicë serbe. Si rrjedhojë, lirinë e tyre të lëvizjes brenda Serbisë e përjetojnë si të kufizuar.

Të intervistuarit ishin të informuar mirë për çështjet që ndërlidhen me lirinë e lëvizjes, kryesisht për arsye se udhëtonin shpesh, ose kishin kontakte profesionale me njerëz nga Kosova. Të gjithë u pajtuan se kjo është një ndër çështjet më të rëndësishme, ngase ndihmon shumë në afrimin e njerëzve dhe stimulon ekonominë. Gjithashtu, të intervistuarit ishin më mirë të informuar edhe për vështirësitë në implementimin e marrëveshjes.

“Arritja e marrëveshjes pati një rëndësi të madhe për njerëzit e këtushëm (Jugu i Serbisë), sepse shumë prej tyre ia mësynë Prishtinës për të punuar ose studiuar. Prandaj, lëvizjet normale të njerëzve nga të dy anët janë shumë të rëndësishme. Më të rëndësishme mendoj se janë për shqiptarët. Edhe serbët nga Kosova përfitojnë nga kjo, por ata janë më të pakët në numër.” (Gazetar, burrë, Vrajë)



“Kam udhëtuar shpesh me veturë në Kosovë dhe kurrë s’kam pasur asnjë problem të vetëm. Por, kam dëgjuar për çështjet e hyrjes në Serbi dhe për anulimin e vulave kufitare të Kosovës nga pasaportat serbe. E di gjithashtu se njerëzit nga Kosova ndonjëherë kanë probleme kur e kalojnë kufirin me Serbinë.” (Gazetar, burrë, Nish)



“Kam parë shqiptarë me dokumente të Kosovës në autobus për Sarajevë, kam qenë disa herë dëshmitare e telasheve që kanë pasur. Nganjëherë i gjithë autobusi mbahej në kufi për të paktën një orë, përderisa nuk përfundonin procedurat e rregullta. Ata (policia kufitare) i nxirrnin njerëzit jashtë dhe i merrnin në pyetje - rregullisht. Pra, mbase marrëveshja edhe është duke u zbatuar, në kuptimin se ata lejohen ta vazhdojnë udhëtimin e tyre, mirëpo ata dhe gjithë njerëzit tjerë në autobus po vuajnë nga ky trajtim aq i keq.” (Aktiviste OSHC, grua, Novi Pazar)



Kur u pyetën nëse nga Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes qytetarët kanë përfitime, shumica e respondentëve u përgjigjën se situata është pak a shumë e njëjtë sikurse para aplikimit të Marrëveshjes. Vetëm disa prej respondentëve, nga Vraja dhe Bujanoci, pohuan se para

Marrëveshjes duhej të paguanin 20 euro për sigurimin e automjetit (për një periudhë shtatë ditëshe) kur hynin në Kosovë, ndërkohë që tani nuk duhet më të paguajnë asgjë. Një respondent nga Beogradi, ndërkaq, foli për lirinë e lëvizjes në përgjithësi:

“Njerëzit e zakonshëm hasin në probleme burokratike, ndërkohë që gjërat që nuk do të duhej ta kalonin fare kufirin – si droga, mallrat e kontrabanduara, etj., lëvizin lirshëm.” (Burrë, 34-vjeçar, Beograd)



MARRËVESHJA PËR REVITALIZIMIN E URËS SË MITROVICËS

Marrëveshja për Revitalizimin e Urës së Mitrovicës është arritur në gusht të vitit 2015. “Ura kryesore” në Mitrovicë është e mbyllur për automjete dhe është e hapur vetëm për këmbësorë. Ekziston një urë tjetër në Mitrovicë që është e hapur për automjete, ndërkaq ura kryesore shërben pothuajse vetëm si një ndarje simbolike mes pjesës jugore të qytetit, të banuar nga shqiptarët, dhe asaj veriore, të banuar me shumicë serbe. Marrëveshja për Revitalizimin

e Urës së Mitrovicës parasheh që ura - me ndihmën financiare të BE-së - të hapet për të gjitha llojet e automjeteve. Deri më tani ura ende nuk është hapur për vetura, e as për çfarëdo lloj automjeteve tjera.

Përshtypjet e përgjithshme në mesin e **respondentëve shqiptarë të Kosovës** ishin se ura duhet të funksionalizohet, e jo të bllokohet, siç është për momentin. Revitalizimi i saj do të ndodhë së shpejti; mund të ketë ndonjë vonesë, por kthim mbrapa nuk ka.


“Urat shërbejnë për lidhjen e njerëzve, por, fatkeqësisht, kjo në Mitrovicë po përdoret për mbajtjen e tyre të ndarë.” (Burrë, 26, Mitrovicë)



Po ashtu, edhe muri që së bashku me parkun u ndërtuan në urë ishin krejtësisht të panevojshëm. U përmend edhe fakti se kjo marrëveshje është një

problem i brendshëm i Kosovës; rrjedhimisht, se ajo nuk do të duhej të diskutohej fare në Bruksel. Një pjesëmarrës në Mitrovicë madje theksoi se:

“Përderisa UNMIK-u ishte ende në Mitrovicë, ai e hapi urën, madje edhe e testoi nëse do të mund të kishte ndonjë incident, por nuk ndodhi asnjë. Mirëpo, duket se ekzistojnë disa interesa të fshehta pse ajo duhet të mbetet e mbyllur.” (Burrë, 35+, Mitrovicë)



Kur u pyetën nëse çështja e hapjes së urës do të ndikonte në jetën e qytetarëve, respondentët e rinj në Prishtinë thanë se kjo gjë do të ishte vetëm një formalitet i cili nuk do të ndikonte në jetën e qytetarëve të Kosovës, meqë “Veriu tashmë

është i humbur për ne”. Në atë pjesë më nuk ekziston përdorimi i gjuhës shqipe dhe gjithkush shihet vetëm flamuri i Serbisë. Veç kësaj, një pjesëmarrës nënvizoi se:

“E kam vështirë ta kuptoj se edhe pse po e shohim që e kemi humbur atë pjesë të vendit tonë, ne jemi krejtësisht komod me këtë gjë; as nuk protestojmë, as nuk kërkojmë përgjegjësi nga qeveria jonë. Jemi mjaft pasiv.” (Burrë, 50, Prishtinë)



Nga ana tjetër, respondentët e rinj shqiptarë të Kosovës, nga Mitrovica e Jugut, pohuan se revitalizimi i kësaj ure do të ndikonte drejtpërsëdrejti në jetën e tyre të përditshme. Madje, shtuan se një revitalizim i tillë do ta lehtësonte edhe trafikun, ngase kjo është ura kryesore e qytetit dhe mbyllja e saj shkakton shumë probleme në trafik, meqë për momentin ekziston vetëm një rrugë kryesore në Mitrovicë. Për pjesëmarrësit më të vjetër në Mitrovicën e Jugut, situata e qetë në veri të Mitrovicës është e përkohshme dhe kjo situatë mund të ndryshojë në çdo kohë. Mendimi i **respondentëve serbë nga Kosova** për çështjen e revitalizimit të urës së Mitrovicës ndërlidhet vetëm me popullatën lokale, meqë kjo çështje u parashtrua vetëm gjatë dy fokus- grupeve të mbajtura në Mitrovicën e Veriut dhe me të intervistuarit në anketimin online. Shumica dërmuese e respondentëve të

rinj serbë nga Kosova pohuan se ura kryesore në Mitrovicë duhet të hapet për trafik, ngase ajo në fund, nëse do të ndërmerreshin veprime të veçanta - siç është kontrolli i shtuar i sigurisë mbi urë dhe përreth saj - do të sillte një situatë më të qetë dhe më të sigurt multietnike për këtë qytet të ndarë etnikisht. Nga ana tjetër, respondentët serbë më në moshë nga Kosova ishin unanimitisht kundër hapjes së urës kryesore për trafik. Pjesëtarët e këtij grupi nënvizuan se, nëse ura hapet së shpejti dhe pa një periudhë përgatitore, ky veprim vetëm sa do ta rrezikonte popullatën lokale serbe që jeton në Mitrovicën e Veriut. Ata po ashtu theksuan se ura kryesore ende ka një rëndësi të madhe simbolike për rezistencën e komunitetit serb të Kosovës (gjatë dhe pas luftës). Edhe po qe se ura do hapej nën masa të larta të sigurisë, respondentët e moshuar serbë nga Kosova nuk u shfaqën të

bindur se do të kishte një rezultat pozitiv. Si argument shtesë, respondentët thanë se ekzistimi i konflikteve të kohë pas kohshme ndëretnike (të nivelit të ulët) dëshmon se komunitetet s'janë ende të gatshme të bëjnë hapin e madh drejt pajtimit – qoftë ai edhe simbolik.

Rezultatet e anketimit online me serbë nga Kosova tregojnë për qëndrime të polarizuara lidhur me hapjen e urës kryesore të Mitrovicës për trafik. Dhjetë nga pesëmbëdhjetë të anketuar (67%) i kanë radhitur shkaqet që i shtyjnë ata të jenë kundër hapjes së urës për trafik – sikurse që janë paraqitur më lartë. Krejt të kundërta ishin përgjigjet e pesë respondentëve (33%), të cilët nënvizuan faktin se ura tashmë funksionon si zonë këmbësorësh, kështu që as futja e trafikut në të nuk do të sillte ndonjë ndryshim drastik, madje as për sa i përket sigurisë së përgjithshme të qytetit të ndarë. Disa prej respondentëve pohuan se fillimisht do të ishte e nevojshme prania e forcave ndërkombëtare mbi dhe përreth urës, derisa ura të mos përshtatej për rolin e saj të ri/të vjetër.

Pjesa më e madhe e respondentëve nga Serbia kanë dëgjuar për urën e Mitrovicës. Disa nga kujtimet e tyre të para për urën kishin të bëjnë me: “trazirat,” “ndarjet etnike,” “barrikadat,” “KFOR-in,” “Murin e Berlinit,” “tregtinë më të lirë në pjesën jugore,” “kufirin,” “17 marsin e vitit 2004.”² Data e trazirave të dhunshme në Kosovë, gjatë të cilave shqiptarët dhe serbët e Kosovës u përplasën mbi urën e Ibrit.]” Sido që të jetë, vetëm disa prej tyre ishin të vetëdijshëm se ura e Mitrovicës ishte njëra nga temat e Dialogut të Brukselit. Një pjesë e respondentëve - përafërsisht gjysma e tyre - nuk e dinin fare nëse ura është hapur për trafik apo jo. Ata që udhëtojnë në Kosovë rregullisht e dinë situatën e urës.

Është interesante se, edhe pse shumica e kujtimeve të para për urën e Mitrovicës ishin negative dhe aludonin në ndarjen e theksuar etnike - shumica e respondentëve e nënvizuan faktin se këmbësorët e kalojnë urën normalisht dhe ata pa asnjë frikë kalojnë në pjesën jugore të qytetit. Disa respondentë e përmendën atë se serbët kanë frikë të flasin serbisht në pjesën jugore të Mitrovicës. Një respondentë nga Beogradi, por me origjinë nga Kosova, e cila Kosovën e viziton shpesh, deklaroi:

“Më shumë frikësohem kur kthehem nga jugu, sepse ka serbë nga kjo anë që mund të më shohin e të më sulmojnë derisa jam duke e kaluar urën.”

(Grua, 45, Beograd)



Është me rëndësi të theksohet se respondentët serbë etnikë janë të ndarë rreth çështjes nëse ura e Mitrovicës duhet të jetë e hapur për trafik, siç përcaktohet me marrëveshje. Disa nga ata mendojnë se ura duhet të jetë e hapur, dhe

këtë gjë e shohin si etapë të domosdoshme për normalizimin e marrëdhënieve. Në grupin e dytë bëjnë pjesë ata që shqetësohen për sigurinë e serbëve të Kosovës, po qe se hapet ura.

“Pajtohem deri në një masë [që ura të jetë e hapur për trafik], edhe pse kjo çështje është stërngarkuar me gjëra pragmatike; fillimisht është e nevojshme të vlerësohet nëse është e sigurt të bëhet kjo gjë, e tek pastaj të hapet.”

(Grua, 20-vjeçare, Beograd)



2. Data e trazirave të dhunshme në Kosovë, gjatë të cilave shqiptarët dhe serbët e Kosovës u përplasën mbi urën e Ibrit.

“Parimisht, do të ishte mirë që [ura] të hapej, por kjo varet nga situata dhe nga kushtet. Nëse do të krijonte probleme, atëherë ndoshta do të duhej që fillimisht t’i zgjidhim problemet e pastaj të hapim urën.” (Burrë, 38, Novi Sad)

(Burrë, 38, Novi Sad)

Nga ana tjetër, të gjithë respondentët me përkatësi etnike shqiptare dhe boshnjake pajtohen me atë që ura e Mitrovicës duhet të jetë e hapur për trafik, sepse një gjë të tillë e shohin si pjesë të domosdoshme të lirisë së lëvizjes.

MARRËVESHJA PËR VULAT DOGANORE

Marrëveshja për Vulat Doganore, e cila synon lehtësimin e shkëmbimit normal të mallrave mes Kosovës dhe Serbisë, është arritur më 2 shtator 2011, ndërsa implementimi i saj ka filluar më 16 shtator 2011. Është arritur pajtimi që vulat e Kosovës dhe i gjithë dokumentacioni përcjellës me mbishkrimin “Dogana e Kosovës” të jenë të pranueshme..

Përgjithësisht, **respondentët shqiptarë të Kosovës** shprehën një skepticizëm të lartë sa i përket ndikimit që marrëveshjet e Brukselit kanë në tregti, biznes dhe punësim. Për ta, marrëveshjet njihen vetëm nga njerëzit që ndikohen drejtpërsëdrejti prej tyre. Marrëveshjet për tregti dhe biznes janë të njohura vetëm nga njerëzit që merren me tregti, ndërkohë që qytetarëve të zakonshëm iu mungojnë informacionet për marrëveshjet e tilla. Ata besojnë se tregtia dhe biznesi zhvillohen ndaras nga politika, se njerëzit që merren me tregti i tejkalojnë të gjitha pengesat aktuale dhe se me palën tjetër bashkëpunojnë vetëm për hir të përfitimeve të tyre.

Respondentët shqiptarë të Kosovës në masë të madhe mendonin se këto marrëveshje nuk janë njësoj të dobishme për të dy shtetet. Shumica e tyre pohuan se marrëveshjet tregtare nuk janë zbatuar asnjëherë nga ana e Serbisë. Rrjedhimisht, Kosova vetëm ka humbur nga Marrëveshja e CEFTA-së, sepse ajo ishte 90% në favor të Serbisë, për arsye se Kosova ishte destinacioni kryesor për eksportimin e mallrave serbe. Gjatë vitit 2018, Kryeministri i Kosovës,

Ramush Haradinaj, rriti tarifën ndaj produkteve serbe, nga 10% në 100%. Shumica e pjesëmarrësve shprehën mendimet e tyre rreth asaj se si ndikoi kjo tarifë në marrëveshjet tregtare. Tarifa prej 100% për të gjitha produktet serbe ndikoi edhe në marrëveshjen e dakorduar me CEFTA-n. Në ndërkohë, produktet serbe ende mbesin pjesë e tregtisë në Kosovë, sepse ato vazhdojnë të hyjnë ilegalisht nëpërmjet veriut të Kosovës.

Nga ana tjetër, për disa prej respondentëve marrëveshjet tregtare ishin të dobishme, sepse ato ofronin një llojllojshmëri produktesh në treg dhe i lejonin konsumatorët që të vendosin vet se cilat do t’i blejnë. Përderisa shumica e respondentëve tarifën e perceptonin si të domosdoshme, sepse si rrjedhojë e saj shumë njerëz tani po blejnë produkte vendore, ajo definitivisht ka ndikuar tek shtresat më pak të pasura, pjesëtarët e të cilave më parë do të zgjidhnin një produkt të lirë sesa ta shikonin origjinën e tij. Këtu duhet nënvizuar edhe fakti se shumica e respondentëve deklaruan se një marrëveshje e reciprocitetit do të ishte më e mirë, sepse do të vlente për dyja palët.

Pjesa më e madhe e **respondentëve serbë nga Kosova** deklaruan se nuk kanë njohuri për Marrëveshjen për Vulat Doganore, e as për përmbajtjen e saj aktuale. Disa prej pjesëmarrësve pohuan se nuk e dinin që Kosova dhe Serbia i kishin njohur reciprocisht vulat doganore, si një formë për lehtësimin e tregtisë. Vetëm një numër i vogël i respondentëve ishin të informuar për Marrëveshjen për Mbledhjen e të Hyrave Doganore. Një respondent madje spekuloi se të hyrat e mbledhura nga pikë-kalimet kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak janë transferuar në Fondin për Zhvillimin e Veriut (të Kosovës). Diskutimi për këto marrëveshje shpeshherë u drejtua edhe kah kritikën ndaj tarifës 100% për produktet e Serbisë, të vendosur së fundmi.

Megjithëse Fondi për Zhvillimin e Veriut të Kosovës ishte themeluar si një instrument për zhvillim ekonomik të katër komunave veriore, as pjesëmarrësit në fokus-grupin e organizuar në Mitrovicën e Veriut dhe as në ato që u zhvilluan në jug të lumit Ibër nuk pohuan se kanë njohuri për ekzistimin e këtij Fondi. Një numër i konsiderueshëm i respondentëve shprehën kritika ndaj mungesës së transparencës së Fondit, dhe konkluduan se fakti që ata nuk posedojnë informacione për funksionimin e këtij institucioni dëshmon për mungesën e transparencës mbi aktivitetet e Fondit.

Kur u pyetën rreth mendimit të tyre për marrëveshjet tregtare mes Kosovës dhe Serbisë, asocimi i parë i pjesës më të madhe të respondentëve nga Serbia ishte tarifa 100 përqindëshe e vendosur nga Qeveria e Kosovës ndaj mallrave të importuara nga Serbia. Që nga ajo kohë, diskursi i mediave serbe në raport me Kosovën dominohet nga lajmet mbi krizën e supozuar humanitare në pjesën e saj veriore, e cila është shkaktuar nga tarifa. Një pjesëmarrëse, e cila punon si gazetare, rrëfeu për përvojën e saj të raportimit rreth situatës në veri të Kosovës:

“Hyra në një dyqan artikujsh ushqimor, dhe ata më pyetën nëse duhet t’i largonin mallrat nga raftet. Unë ju thashë jo, dhe i pyeta se përse duhej ta bënin një gjë të tillë. Më thanë se zakonisht u kërkohej të vepronin kështu kur vinin gazetarët, në mënyrë që kamera t’i regjistrojë raftet e zbrazëta.”

(Grua, 28-vjeçare, Kragujevc)



Sa i përket periudhës para tarifës, shumica e respondentëve besojnë se tregtia mes Serbisë dhe Kosovës ishte e zhvilluar mirë dhe bëhej në dobi të dy palëve. Disa nga respondentët deklaruan se para lajmeve për vendosjen e tarifës nuk kishin dëgjuar asgjë për tregtinë mes dy vendeve. Disa pjesëmarrës theksuan se, vetë fakti që po flasim për import dhe eksport mallrash nënkupton se ekzistojnë dy shtete, dhe kjo, sipas tyre, është kontradiktore me qëndrimin zyrtar të Qeverisë së Serbisë. Në lidhje me periudhën e fundit – pas vendosjes së tarifës – respondentët kishin mendime të ndara nëse

tarifa ndikoi në shkëmbimin e mallrave, ose jo. Disa pjesëmarrës nga Novi Pazari nënvizuan se tarifa dëmin më të madh ua ka shkaktuar ndërmarrësve nga rajoni i Sanxhakut, të cilët merren me transportimin e mallrave mes Kosovës dhe Serbisë. Disa respondentë dhanë deklarata të përgjithshme, sipas të cilave tarifa e ka dëmtuar tregtinë. Megjithatë, shumica e respondentëve u shprehën se tregtia ka vazhduar – ndonëse nëpërmjet kanaleve ilegale. Po ashtu, shumica e respondentëve besojnë se lajmet për një krizë humanitare në veri të Kosovës janë të ekzagjeruara dhe i shërbejnë vetëm propagandës.

“Tarifa është imponuar, dhe ishte një lëvizje e keqe e Qeverisë [së Kosovës], megjithëse ajo nuk ndikoi në furnizimin e komunave [veriore], sepse furnizimi atje është ende i mirë gjithkund. Po përdoren vend kalimet ilegale, kështu që serbët e Kosovës nuk janë dëmtuar fare nga tarifa. Ndikimi pra është zero, dhe ajo s’paraqet asgjë tjetër përveçse një lëvizje politike”

(Burrë, 21-vjeçar, Beograd)



“E kam një shok që është pronar i një dyqani [në veri të Kosovës]. E thirra menjëherë që ta pyesja, dhe ai më tha: Mos u bëj e marrë [...], po sillesh sikur nuk ke jetuar kurrë këtu. Dyqani im është përplot me gjithçka.”

(Grua, 45, Beograd)



“Krejt ajo që shohim në media nuk ka asnjë lidhje me realitetin. Për shembull, ky rrëfimi për tarifën është i sajuar. Ajo [tarifa] ekziston, por krizë humanitare nuk ka.” (Burrë, 29 vjeçar, Vrajë)



Të intervistuarit besojnë se tregtia e lirë dhe bashkëpunimi ekonomik janë elementet kryesore për normalizimin e marrëdhënieve, por

edhe se ato mund të zgjerohen edhe në fusha tjera. Kjo gjë është e një rëndësie të veçantë për rajonet që shtrihen në afërsi të Kosovës.

“Bashkëpunimi mes dy Odave Ekonomike ka përparuar shumë më tepër se format tjera të bashkëpunimit. Ekziston një numër i madh i ndërmarrësve që marrin pjesë nëpër panairët afariste. Një i tillë i vogël u mbajt në Bujanoc dhe pjesë e tij ishin edhe disa prodhues lokalë nga Kosova. Ky lloj bashkëpunimi i ekonomisë serbe ia ka hapur edhe dyert e Shqipërisë, gjë që s’ka ndodhur asnjëherë më parë. Madje, disa ndërmarrje janë bërë bashkë dhe janë prezantuar bashkërisht edhe në një panair në Stamboll.”

(Gazetar, Burrë, Vrajë)



“Përveç punës time të rregullt, unë kam edhe një ndërmarrje të vogël që prodhon raki kumbulle, dhe ne bashkëpunojmë shumë mirë me Kosovën. Ne madje edhe e shesim produktin tonë atje, dhe kemi marrë pjesë në disa panire. Asnjëherë nuk ka pasur asnjë problem, përveç faktit që është vështirë të lidhesh me prodhuesit tjerë në Kosovë.” (Aktivist, Burrë, Kralejë)



LIBRAT E REGJISTRIT CIVIL

Marrëveshja për Librat e Regjistrimit Civil është arritur më 2 korrik 2011, dhe ajo është implementuar në tërësi. Serbia ia ka kthyer Kosovës 12,036 kopje të skanuara të librave të regjistrimit civil, të vërtetuara nga ana e EULEX-it, të cilat ishin marrë në kohën e luftës. Librat që përmbajnë datat e lindjeve, martesave dhe të vdekjeve, janë vërtetuar dhe i janë kthyer Kosovës si pjesë e Procesit të Përpunimit të të Dhënave të Statusit Civil.

Shumica dërrmuese e **responentëve shqiptarë të Kosovës** ishin të informuar për Marrëveshjen për Librat e Regjistrimit Civil. Sipas tyre, ajo ua ka lehtësuar qytetarëve serbë marrjen e dokumenteve kosovare. Mirëpo, ata nënvizuan se vetëm një pjesë shumë e vogël e serbëve të Kosovës vendosin që t’i marrin dokumentet kosovare, gjë që pastaj krijon përshtypjen sikur kjo marrëveshje nuk ka qenë aq efektive.

Megjithëse pyetjet në lidhje me Marrëveshjen për Librat e Regjistrimit Civil nuk u përfshinë gjatë hulumtimit të OJQ-së AKTIV, **responentët serbë nga Kosova** e përmendën këtë marrëveshje,

për shkak të rëndësisë që ka për komunitetin serb të Kosovës, andaj ata edhe i shprehën këndvështrimet e tyre rreth kësaj çështjeje. Shumica e pjesëmarrësve pohuan se nuk kanë njohuri rreth procesit të implementimit, edhe pse shpresonin se marrëveshja do të implementojë së shpejti, për shkak të rëndësisë që ka për jetën e përditshme të komunitetit. Shumica dërmuese e respondentëve nga Serbia ose nuk kishin dëgjuar asnjëherë për Marrëveshjen për Librat e Regjistrat Civil, ose kishin dëgjuar për të por s'kishin asnjë njohuri rreth përmbajtjes së saj. Ata që kishin dëgjuar për marrëveshjen nuk mendonin se ajo iu mundësoi ndonjë

përfitim qytetarëve. Është interesante të thuhet se, përkundër asaj se Marrëveshja për Librat e Regjistrat Civil zakonisht promovohet si shembull i një implementimi të suksesshëm, respondentët tregojnë i vetëm i prekur drejtpërdrejt nga marrëveshja pohoi se ajo për të ishte një përvojë jashtëzakonisht negative. Ai dhe gruaja e tij janë me origjinë nga Kosova, por aktualisht jetojnë në Novi Sad. Gruaja e tij nuk kishte mundur të merrte kopjen e certifikatës së lindjes – ishin përprjekur edhe në Serbi (në Kragujevc) edhe në Kosovë (në Klinë), por pa sukses. Pasojat negative të këtij rasti patën ndikim edhe në fëmijën e tyre.

“Unë nuk po mund ta regjistroj gruan time në adresën ku jetojmë –sepse s’po mund ta marrim certifikatën e saj të lindjes. Ajo ka letërnjoftim të Kosovës. Kur sëmuret ka probleme në spital, dhe duhet të vijë policia për ta identifikuar. Ata [personeli i spitalit] nuk donin të asistojnë në lindjen e fëmijës tonë derisa nuk e vërtetuan identitetin e gruas sime. E tani, unë s’po mundem ta regjistroj fëmijën tim në adresën ku e kemi shtëpinë. Kërkova ndihmë nga disa OJQ dhe ato më drejtuan në Kragujevc, pastaj edhe në Klinë [për të tentuar të gjente certifikatën e lindjes së gruas së tij] ... Tani, fëmija jonë s’ka sigurim shëndetësor. Nëse vërtet mendojnë se Kosova është pjesë e Serbisë, atëherë duhet të na i japin dokumentet.” (Burrë, 24-vjeçar, Novi Sad).

(Burrë, 24-vjeçar, Novi Sad)



Për sa i përket të intervistuarve, shumica e tyre kanë dëgjuar për Marrëveshjen, veçanërisht ata që jetojnë në qytetet ku Librat e Regjistrat Civil ishin transferuar pas luftës në Kosovë (Kragujevc dhe Nish). Një bashkëbisedues nga Kragujevc punon në një organizatë që iu ndihmon romëve për të marrë letërnjoftime personale dhe në procesin e ri-integrimit të tyre pas kthimit nga vendet e BE-së, kështu që ai kishte një përvojë të madhe në çështjet me të cilat përballen njerëzit.

E dyta është një aktiviste civile, po ashtu nga Kragujevc, e cila punon në njësinë e administratës së qytetit që merret me trajtimin e këtyre dosjeve. Ajo ishte e vetmja që kishte njohuri për nivelin e implementimit të Marrëveshjes, për shkak se ishte personalisht e përfshirë në kopjimin e librave.

REGJISTRAT KADASTRALË

Marrëveshja për Regjistrat Kadastralë është arritur më 2 korrik 2011. Ajo parasheh krijimin e një kadastrë të besueshëm në Kosovë, nëpërmjet kthimit nga Serbia të kopjeve të skanuara të regjistrave kadastralë të Kosovës të para vitit 1999, dhe me krijimin e një agjencie teknike që do t'i identifikonte zbrazësitë ekzistuese në Kadastrën e Kosovës. Të dy palët e kanë vonuar vazhdimisht implementimin e kësaj marrëveshjeje.

Fillimisht, ishte pala kosovare ajo që e vonoi për disa vjet miratimin e ligjit për agjencinë e re teknike - Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), e nga ana tjetër, nëpërmjet një vendimi, Gjykata Kushtetuese e Serbisë vendosi se Marrëveshja kadastrale është në kundërshtim me Kushtetutën serbe.

Shumica e *respondentëve shqiptarë të Kosovës*, kryesisht të moshës mbi 35-vjeçare, ishin të informuar për marrëveshjen për regjistria kadastral. Ata e nënvizuan rëndësinë e kësaj marrëveshje për njerëzit që kanë punuar para luftës. Megjithatë, ata po ashtu theksuan se nuk kishin informata nëse kjo marrëveshje po zbatohet, prandaj edhe dyshonin se Serbia do t'i kthente të gjithë librat e regjistrit kadastral.

Respondentët serbë nga Kosova, ndërkaq, nuk u pyetën fare për këtë marrëveshje.

Përgjithësisht, kjo marrëveshje është pothuajse e panjohur për të gjithë respondentët nga Serbia. Vetëm një pakicë e vogël e tyre kanë dëgjuar për të, ndonëse askush nuk kishte njohuri për përmbajtjen e saj, e as për nivelin e implementimit.

NJOHJA E NDËRSJELLË E DIPLOMAVE UNIVERSITARE

Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të diplomave universitare është arritur më 2 korrik 2011. Kosova dhe Serbia u pajtuan përnjë mekanizëm ndërkombëtar për certifikimin e diplomave që të drejtohej nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane (EAU). Megjithëkëtë, marrëveshja ende nuk është implementuar plotësisht. Si rrjedhojë, shtetasit shqiptarë të Serbisë (kryesisht nga Lugina e Preshevës) që janë shkolluar në Kosovë nuk mund të punësohen apo ta vazhdojnë shkollimin në Serbi. Pak më e mirë është situata për sa i përket njohjes së diplomave serbe në Kosovë, megjithëse edhe numri i tyre vazhdon të mbetet simbolik.

Respondentët shqiptarë të Kosovës e cekën Marrëveshjen për Njohje të Diplomave si marrëveshjen kryesore të cilën Serbia nuk e

implementon, edhe pse Kosova i njeh diplomat e Serbisë. Shumica e respondentëve iu referuan marrëveshjes si një shembull që dëshmon se Dialogu Teknik nuk ka qenë fare efektiv.

Shumica e *respondentëve nga radhët e serbëve të Kosovës* nuk kishin njohuri për detajet e Marrëveshjes për Njohjen e Ndërsjellë të Diplomave. Të rinjtë nga të gjitha komunat e përfshira ishin relativisht mirë të informuar lidhur me verifikimin e diplomave të fituara në Universitetin e Prishtinës në Mitrovicën Veriore nga sistemi arsimor i Kosovës. Respondentët e cekën problemin e nostrifikimit dhe të njohjes së diplomave të fituara nëpër universitetet e Serbisë, por edhe atë se procesi administrativ është tejet i ndërlikuar dhe i ngadalshëm. Ata vunë në dukje se procesi i verifikimit të diplomave duhet të përshpejtohet, meqenëse një numër i madh i të rinjve serbë nga Kosova janë të gatshëm të punësohen nëpër institucionet e Kosovës. Në këtë mënyrë, gjeneratat e reja do të kishin mundësi të kenë të ardhura të qëndrueshme, dhe kjo gjë pastaj do t'ua mundësonte të qëndrojnë dhe të jetojnë në Kosovë.

Përafërsisht gjysma e të gjithë *respondentëve nga Serbia* kishin dëgjuar për këtë Marrëveshje. Madje, disa prej tyre mendonin se ajo ishte implementuar, përderisa pjesa tjetër e dinte se nuk ishte kështu. Një numër i madh i pjesëmarrësve - serb dhe boshnjak - mendonin se marrëveshja ishte implementuar, meqenëse Serbia i pranon diplomat e lëshuara nga universitetet në Kosovë që funksionojnë si pjesë e sistemit arsimor serb. Mirëpo, pasi u sqarua se Marrëveshja parasheh njohjen e diplomave të lëshuara nga të gjitha universitetet e Kosovës, përfshirë ato që i përkasin sistemit arsimor të Kosovës - dhe anasjelltas - shumica u pajtuan se ajo duhet të implementohet, ngase një gjë e tillë do ta lehtësonte ndjeshëm jetën e njerëzve. Në ndërkohë, disa nga respondentët i shprehën dyshimet e tyre për cilësinë e arsimit në Kosovë. Njëri madje tha:

“Është e diskutueshme se çfarë janë shkollat atje, në Prishtinë. Pse do ta lejonim ne [një mjek] t’i trajtojë njerëzit këtu?” (Burrë, 30-vjeçar, Vrajë)



Megjithatë, si mendim i përgjithshëm i responentëve doli ai se diplomat duhet të pranohen reciprokisht, me kusht që ato të jenë lëshuar nga universitetet e akredituara zyrtarisht.

Për dallim prej serbëve e boshnjakëve, shqiptarët nga Lugina e Preshevës e dinin se Marrëveshja

për Pranimin e Ndërsjellë të Diplomave nuk është implementuar, kjo për arsye se ata janë pjesë e popullatës e cilai vuan më së tepërmi pasojat e mosimplementimit të saj. Pjesa më e madhe e responentëve me përkatësi etnike shqiptare studiojnë ose kanë studiuar në universitetet e Kosovës. Njëri nga ata deklaroi:

“Në vitin 2013 dhe në vitin 2014 u përpoqa ta nostrifikoja diplomën time. Edhe tani sërish e kam filluar procedurën e njëjtë. Dikush, pra, edhe mund ta fillojë procedurën – porkurrë nuk merr asnjë përgjigje.”

(Burrë, mes të 20 -30-ave, Bujanoc)



Gjithashtu, të gjithë responentët me përkatësi etnike shqiptare që jetojnë në Serbi u pajtuan se shqiptarët në Serbi nuk janë të integruar mirë nëpër institucionet shtetërore –si policia, gjyqësori, spitalet apo universitetet. Siç u theksua nga një pjesë e responentëve, në këto

institucione praktikisht nuk ka asnjë shqiptar që mban pozitë të lartë. Për më tepër, responentët me etni shqiptare besojnë se serbët në Kosovë janë të integruar shumë më mirë në sistemin e Kosovës, dhe se të drejtat e tyre mbrohen më mirë se ato të pakicës shqiptare në Serbi.

“Pakica serbe në Kosovë është më e integruar dhe më e respektuar nga autoritetet, sesa ne shqiptarët në Serbi. Nuk ka sa duhet gjyqtarë shqiptarë, e as zyrtarë policie në poste të larta, duke marrë parasysh numrin e madh të popullatës shqiptare në Bujanoc.” (Burrë, 20vjeçar, Bujanoc)



Shumica e responentëve kishin njohuri për marrëveshjen, megjithëse vetëm ata që jetonin në rajonet e prekura nga ajo ishin të informuar lidhur me implementimin e saj.

“Diplomat janë një problem shumë i madh, dhe i tillë ishte edhe para se të arriheshin marrëveshjet. Që nga viti 2002 ka pasur përpjekje për zgjidhjen e kësaj çështjeje, por ajo nuk u zgjodh asnjëherë. Shqiptarët nuk kanë zgjidhje tjetër përpos që të studiojnë në Prishtinë, Tiranë ose Maqedoni. Nëse e zgjedhin Prishtinën, ata s’mund të kthehen e të punojnë në Bujanoc, sepse në diploma iu shkruan se ato janë lëshuar nga Republika e Kosovës.”

(Gazetar, Burrë, Vrajë)



MARRËVESHJA PËR ENERGJI

Marrëveshja për Energji është arritur më 8 shtator 2013, dhe ajo parasheh themelimin e bashkëpunimit mes operatorëve të sistemit të transmisionit dhe autoriteteve rregullatore të energjisë. Marrëveshja e rikonfirmon angazhimin e të dy palëve për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë për zbatimin e akteve ligjore të BE-së për energjinë. Në përputhje me hapjen e tregut të energjisë, marrëveshja parasheh themelimin e një ndërmarrjeje të re për furnizim me energji të komunave veriore të Kosovës, e

cila funksionon në kuadër të ligjeve të Kosovës. Shumica e *respodentëve shqiptarë të Kosovës* kishin dëgjuar për Marrëveshjen për Energji. Mirëpo, pjesa dërrmuese e tyre pohuan se për të dinë vetëm në bazë të emrit, ngase nuk e dinë fare se çka nënkupton apo si ndikon ajo në raport me Kosovën dhe qytetarët e saj. Një numër i vogël i respodentëve ishin më të informuar. Duhet theksuar se respodentët me moshë mbi 35-vjeçare ishin më të informuar për marrëveshjen sesa ata me moshë të re. Sipas tyre, kjo është një marrëveshje shumë e rëndësishme për Kosovën, megjithëse Serbia po e bllokoi implementimin e saj.

“Kosova në këtë mënyrë po humbë miliona euro për çdo vit, gjë që e dëmton rëndë buxhetin e Kosovës. Kjo është njëra prej marrëveshjeve më të rëndësishme, ngase Kosova blen energji nga Shqipëria, por s’mund të blejë edhe nga Hungaria. Korporata energjetike nuk është e pavarur siç do të duhej, sepse në ende nuk e kemi një domen tonin të pavarur”.

(Burrë, rreth të 30-ave, Prizren)



Ngjashëm, edhe një respodent tjetër nënvizoi se Kosova ende nuk e kontrollon hapësirën e saj ajrore, dhe se kosovarët akoma evidentohen vetëm si banorë, e jo si shtetas. U përmend po ashtu se qytetarët kosovarë vazhdojnë të paguajnë faturat e energjisë elektrike të shpenzuar nga serbët që jetojnë në veri të Kosovës.

Të gjithë *respodentëve serbë të Kosovës* ndërkaq iu mungonin informacionet rreth përmbajtjes dhe për procesin e implementimit të Marrëveshjes për Energji.

Shumica e *respodentëve nga Serbia* nuk kishin dëgjuar fare për Marrëveshjen për Energji. Disa prej tyre - gati në të gjitha fokus-grupet - këtë marrëveshje, gabimisht, e ndërlidhnin me rregullimin e pronësisë dhe me menaxhimin e Liqenit të Gazivodës dhe Minierës së Trepçës. Asnjëri nga respodentët nuk kishte njohuri për përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje. Duhet thënë edhe ajo se, pothuajse në të gjitha fokus-grupet kishte nga disa respodentë që pohonin se njerëzit që jetojnë në Kosovë (qofshin ata serbë apo shqiptarë) nuk i paguajnë fare faturat për

energjinë elektrike dhe se - në mënyrë indirekte - janë shtetasit e Serbisë ata që e bartin koston e konsumit të kësaj energjie elektrike.

Për sa i përket të intervistuarve, shumica e tyre kishin dëgjuar për Marrëveshjen, por asnjëri nuk mund ta thoshte qartë se për çfarë saktësisht janë pajtuar palët.

MARRËVESHJA PËR TELEKOMUNIKACIONIN

Telekomunikacioni ishte njëra nga temat e diskutuara gjatë gjithë dialogut teknik, dhe marrëveshja përfundimtare për këtë lëmi u arrit më 8 shtator 2013, me nënshkrimin e Planit të Veprimit për implementimin e Marrëveshjes për Telekomunikacion. Marrëveshja i siguroi Kosovës kodin e saj të telekomunikacionit, në përputhje me standardet e ITU-së, si dhe mundësoi ndalimin e punës së ë gjitha ndërmarrjeve të paligjshme të telekomunikacionit që operonin në Kosovë. Ajo lejoi hapjen e një ndërmarrjeje

të telefonisë mobile për veriun e Kosovës dhe siguroi garanci operimi për një nëndegë të ndërmarrjes serbe e cila do të ofronte shërbime fikse të telekomunikacionit në veri – NewCo. Të dy këto ndërmarrje duhet të operonin në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës. Marrëveshja inkurajon edhe miratimin e marrëveshjeve shtesë, që ndërlidhen me interkoneksionin, romingun dhe shërbimet

postare. Ajo po ashtu parasheh uljen e tarifave lokale për qytetarët e të dy shteteve. Të gjithë responentët shqiptarë të Kosovës ishin të informuar për marrëveshjen për Telekomin. Kjo për ata ishte e vetmja marrëveshje që deri më tani u implementua plotësisht, dhe që ndikoi në jetën e tyre të përditshme. Megjithatë, njëri prej pjesëmarrësve shprehu shqetësimin e tij:

“Kjo marrëveshje nuk po zbatohet plotësisht, ngase kodi +383 nuk po funksionon siç duhet jashtë territorit të Kosovës. Nuk është kjo një marrëveshje aq e qëndrueshme, siç po besohet.” (Burrë, 32, Pejë)



Vështrimet e shprehura nga të dy fokus-grupet dhe në anketimin online dëshmuar për një pakënaqësi tejet të përhapur mes responentëve serbë në Kosovë lidhur me implementimin e Marrëveshjes për Telekomunikacion. Kritikën e responentëve kryesisht ndërlidhen me punën dhe funksionimin e ndërmarrjes simotër të telekomunikacionit nga Serbia, MTS d.o.o., e cila u themelua si pjesë e Marrëveshjes. Një numër i konsiderueshëm responentësh u ankuan edhe për çmimet e larta të shërbimeve të komunikimit të ndërmarrjes MTS d.o.o., veçanërisht, kur ato të krahasohen me cilësinë e dobët të shërbimeve që ofrohen nga kjo kompani.

Çështja më shqetësuese për responentët serbë nga Kosova ishte se MTS d.o.o. nuk e mbulon me sinjal gjithë territorin e Kosovës, por vetëm zonat e banuara nga pjesëtarët e komunitetit serb. Pakënaqësia e krijuar nga kjo gjë pastaj ndikoi që shumë prej pjesëmarrësve ta ndërronin operatorin e tyre të telefonisë mobile, veçanërisht ata që jetojnë në jug të lumit Ibër. Responentët nënvizuan edhe atë se sistemi i komplikuar i kontaktimit të përdoruesve të operatorëve tjerë të telefonisë mobile në Kosovë është tejet i bezdisshëm. Për më tepër, ata patën vërejtje edhe në politikën e MTS d.o.o., sipas të cilave klientët e mundshëm duhen domodoshmërisht të kenë

letërnjoftime të lëshuara nga Kosova, si kusht për ta fituar të drejtën e përdorimit të shërbimeve të tyre. Edhe pse, si rrjedhojë e Marrëveshjes, sinjali i MTS d.o.o. është zgjeruar edhe në një numër vendbanimesh në jug të lumit Ibër, shërbimet e ofruara vazhdojnë të cilësohen si të dobëta. Nga argumentet e responentëve, të numëruara më sipër, rezulton se të gjithë ata e vlerësuan negativisht punën e MTS d.o.o. dhe, rrjedhimisht, edhe Marrëveshja për Telekomunikacionin u vlerësua ngjashëm.

Një numër i **responentëve nga Serbia** kishin dëgjuar për Marrëveshjen për Telekomunikacionin, si të tillë, ndërsa shumica e tyre kishin dëgjuar se Kosova tashmë e posedon edhe kodin e saj shtetëror - i cili poashtu ishte pjesë e Marrëveshjes. Disa nga responentët që udhëtojnë në Kosovë, por edhe ata që kanë të afërm dhe miq këtu, deklaruan se numrat e telefonave mobilë serbë ende funksionojnë brenda zonave të banuara me shumicë serbe, përderisa të tjerët e përmendën faktin se kur udhëtonin në Kosovë, ose ishin në roaming, ose nuk kishin sinjal fare. Shqiptarët e Luginës së Presheves, nga ana tjetër, ishin shumë të kënaqur me Marrëveshjen dhe me nivelin e implementimit të saj –ngase, siç u theksua nga shumica e tyre, ajo lehtësoi komunikimin e tyre me telefona mobil me të afërm e miq nga Kosova.

“Para marrëveshjes, ne nuk mund t’iu shkruanim njerëzve në Kosovë. Tani gjithçka funksionon normalisht.” (Burrë, 30-vjeçar, Bujanoc)



Të intervistuarit, edhe pse të informuar për marrëveshjen për telekomunikacionin, nuk janë të sigurt se si është paraparë funksionimi i saj dhe as se çfarë është rregulluar nëpërmjet saj.

“Unë nuk e di asnjë detaj të marrëveshjes, përveç se Kosova tani ka kod të ri, dhe se tani mund të bëhen thirrje atje, sepse këtë gjë e bëj shpesh. Mirëpo, edhe pse përmes telefonit mobil tani mund t’i telefonoj njerëzit në Prishtinë, unë ende s’mund ta telefonoj askënd në Ferizaj. Nuk e di arsyen pse ndodhë kjo gjë.” (Aktiviste, Grua, Novi Pazar)



HAPJA E ZYRAVE NDËRLIDHËSE

Me qëllim të avancimit të marrëdhënieve mes dy shteteve, por edhe të lehtësimit të komunikimit dhe përfaqësimit të përhershëm, me fokus implementimin e marrëveshjeve të dialogut teknik të ndërmjetësuar nga BE-ja dhe menaxhimin e vizitave zyrtare, Kosova dhe Serbia janë pajtuar që të emërojnë nga një zyrtar të tyre ndërlidhës, me zyra funksionale brenda objekteve të BE-së që operojnë në të dy vendet. Shkëmbimi i zyrtarëve ndërlidhës u realizua më 31 maj 2013, ndërkohë që palët u pajtuan edhe rreth dispozitave që do të aplikohen për Zyrtarin Ndërlidhës dhe personelin e tij.

Pjesa dërrmuese e **responentëve të rinj shqiptarë të Kosovës** nuk ishin të informuar për atë se Kosova ka zyrën e saj ndërlidhëse në Beograd, e as që Serbia ka zyrën e vet ndërlidhëse në Kosovë. Së këndejmi, ata e cilësuan si shumë të keq faktin që nuk ishin të informuar për këto zyra, andaj edhe patën pyetje të ndryshme për sa i përket përdorimit të emrit, flamurit dhe simboleve tjera të Kosovës në atë zyrë. Vetëm një numër i vogël i responentëve thanë se kishin njohuri për ekzistimin e zyrave të tilla. Mirëpo, edhe ata ishin skeptikë rreth fuqisë dhe ndikimit që zyra ndërlidhëse e Kosovës mund ta ketë në Beograd. Ndryshe, ky ishte edhe një rast tjetër i përmendjes së jo-transparencës, meqë pjesëmarrësit qartazi vunë në dukje se nuk e dinin nëse kjo zyrë funksiononte ende ose jo.

Të gjithë **responentët serbë nga Kosova** - pa asnjë përjashtim - deklaruan se nuk ishin të informuar, e as nuk kishin njohuri për punën e Zyrave Ndërlidhëse në Prishtinë dhe Beograd.

Një numër shumë i vogël i **responentëve nga Serbia** kishin dëgjuar për Zyrtarët Ndërlidhës-respektivisht për Zyrtarin Ndërlidhës të Kosovës që shërben si pikë kontakti në Beograd, dhe anasjelltas. Edhe ata që kishin dëgjuar nuk e dinin se cilat ishin qëllimet dhe as kompetencat e zyrtarëve ndërlidhës. Katër responentë - nga Novi Pazari, Beogradi, Nishi dhe Vraja - pohuan se zyrtarët ndërlidhës i shohin si njëloj zëvendësimi të ambasadorëve, meqenëse Serbia dhe Kosova nuk kanë marrëdhënie zyrtare diplomatike. **Responentët me përkatësi etnike shqiptare** kryesisht kishin njohuri për zyrtarët ndërlidhës, dhe përgjithësisht pajtoheshin se këta zyrtarë duhen quajtur ambasadorë. Vetëm një responent (nga Novi Pazari, i grupmoshës mbi 30-vjeçare) e dinte emrin e Zyrtarit Ndërlidhës të Serbisë. Megjithatë, praktikisht të gjithë responentët mendonin se ky institucion nuk i kontribuon në asnjë mënyrë mirëqenies së qytetarëve.

INTEGRIMI I DREJTËSISË DHE POLICISË

Marrëveshja për parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve, e njohur edhe si Marrëveshja e Brukselit, është nënshkruar fillimisht në vitin 2013, dhe ajo, mes tjerash -nëpërmjet marrëveshjeve shtesë të nënshkruara gjatë vitit 2013 - parasheh integrimin e policisë (marrëveshjet e nënshkruara në vitin 2013) dhe gjyqësorit (marrëveshjet e nënshkruara në vitin 2015) që operojnë në veri të Kosovës brenda institucioneve të Kosovës, respektivisht që këto institucione të punojnë sipas kornizës ligjore të Kosovës. Kjo marrëveshje dhe ato vijuese për policinë dhe drejtësinë mundësuan krijimin e një sistemi unik të policisë dhe të drejtësisë

në veri të vendit, dhe integrimin e personelit serb në institucionet shtetërore të drejtësisë në Kosovë. Në bazë të marrëveshjes për drejtësi është themeluar një gjykatë themelore dhe një prokurori për shtatë komunitetet e rajonit të Mitrovicës, ashtu siç edhe përcaktohet me Ligjin për Gjykatat të Republikës së Kosovës. Shumica dërmuese e **respodentëve shqiptarë të Kosovës** ishin të informuar për marrëveshjet për drejtësi dhe për integrimin e policisë. Madje, ata si referencë të drejtpërdrejtë e morën shpërbërjen e strukturave paralele serbe në veri të Kosovës. Respodentët me moshë mbi 35-vjeçare ishin më të informuar lidhur me këtë marrëveshje. Megjithatë, duhet të theksohet se përshtypjet e tyre nuk ishin plotësisht pozitive, ngase ishin skeptikë nëse kjo strukturë e mëparshme vërtet ndjehej pjesë e sistemit të drejtësisë kosovare dhe e Qeverisë së Kosovës.

Integrimi i policisë u mirëprit në mënyrë deri diku neutrale nga popullata lokale në veri të Kosovës, pas një periudhe të gjatë të ekzistimit të vakumit në fushën e sigurisë që mbizotëronte në atë pjesë të Kosovës. Shumica e **respodentëve serbë nga Kosova** thanë se procesi i integritit të policisë në Veri fillimisht ishte i suksesshëm, megjithëse angazhimi dhe performanca e zyrtarëve u cilësua si negative. Reagimet në të dy fokus-grupet në Mitrovicën e Veriut treguan se ekziston një mosbesim i përhapur ndaj pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, se ata nuk i kontribuojnë sigurisë publike. Respodentët theksuan se personeli policor në veri ka nevojë për ndryshime, meqë ai i tanishmi përbëhet nga anëtarë të moshuar që, sipas perceptimit të tyre, është goxha joefektiv. Rrjedhimisht, respodentët besojnë se brenda personelit të Policisë së Kosovës në veri duhet të ndodhë një “ndërrim i gjeneratës”, i cili besohet se do të ndikonte në ngritjen e efektshmërisë së zbatimit të ligjit.

Gati të gjithë respodentëve nga radhët e serbëve nga Kosova iu mungonin informacionet mbi integrimin e ish-pjesëtarëve të Mbrojtjes Civile. Disa respodentë pohuan se jozyrtarisht kishin dëgjuar për raste kur dikush nga personeli i

Mbrojtjes Civile ishte integruar në institucionet e Kosovës, si dhe se disa prej tyre ishin pensionuar nga Serbia, por asgjë më shumë se kaq.

Duke marrë parasysh se integrimi i gjyqësorit në veri të Kosovës tashmë është implementuar, respodentët nga të dy fokus-grupet në Mitrovicën e Veriut u pajtuan se procesi i integritit është i ngadalshëm dhe ka nevojë për ndërhyrje të mëtutjeshme të bashkësisë ndërkombëtare.

Pjesëmarrësit në fokus-grupe numëruan keqpërdorime të shumta gjatë zbatimit të Marrëveshjeve, si: përkthimi joadekuat nga shqipja në serbisht i dokumenteve gjyqësore dhe ligjeve, gjykimet që zgjasin për vite të tëra, mungesa e personelit të shkolluar e me përvojë, dhe vendimet joproporcionale gjyqësore. Edhe pse, sipas respodentëve, struktura e Gjykatës në Mitrovicën e Veriut, për sa i përket personelit të saj shumetnik, është realizuar mirë, kjo gjë nuk garanton vendime të drejta gjyqësore.

Në përgjithësi, respodentët nuk ishin të kënaqur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, kështu që nënvizuan se besimi i popullatës lokale në gjyqësorin e integruar është ende i ulët. Sipas tyre, ky mosbesim vjen edhe si pasojë e besimit të madh që popullata lokale ka në sistemin gjyqësor të Serbisë, në vend se në atë të Kosovës.

Praktikisht, të gjithë **respodentët nga Serbia** kishin dëgjuar për Marrëveshjen e Brukselit, por vetëm një numër i vogël i tyre kishin njohuri rreth përmbajtjes së saj. Vetëm disa respodentë e dinin se Marrëveshja e Brukselit rregullon integrimin e policisë dhe të gjyqësorit, megjithëse shumica kishin dëgjuar për integrimin e policisë dhe gjyqësorit në veri të Kosovës. Është me rëndësi të thuhet se në disa fokus-grupe respodentët (të etnisë serbe) theksuan se Serbia i ka përmbushur të gjitha detyrimet e saj, që dalin nga Marrëveshja e Brukselit, ndërkohë që Kosova nuk ka përmbushur asgjë. Megjithëkëtë, shumica e tyre e pranuan se nuk i dinin detajet e marrëveshjes, dhe se gjithçka që dinin e kishin dëgjuar nga mediat.

“Asgjë nga ajo që Kosova do të duhej të përmbushte nuk ka ndodhur, ndërsa nga ana jonë –të gjitha.” (Grua, 45vjeçare, Beograd)



Për sa i përket integrimit të policisë dhe gjyqësorit, respodentët kishin mendime të ndryshme rreth asaj nëse integrimi është një gjë e mirë, ose jo. Shumica e përkrahnin integrimin.

“Integrimi është i rëndësishëm - njerëzit janë të lidhur me njëri-tjetrin dhe ata duhet të jetojnë së bashku, prandaj ata duhet të mësohen se policia dhe gjyqësori të jenë multietnik.” (Burrë, në të 20-at, Novi Pazar)



“Unë mendoj se [integrimi] është i mirë, sepse nëse jeton atje duhet të integroresh. Njësoj sikurse që kosovarët [serbët e Kosovës] nuk duan të integrohen këtu, por vazhdojnë ashtu siç janë mësuar. Ata s’janë socializuar fare, por i kanë ruajtur sjelljet dhe të folurën e tyre, kështu që asnjëri s’ka miq në mesin e vendasve. Njeriu duhet të integrohet në vendin ku jeton. Unë Kosovën e shoh si pjesë të Serbisë.” (Grua, 49-vjeçare, Krlevë)



Të gjithë respodentët e etnisë shqiptare besojnë se serbët nga Kosova duhet të jenë plotësisht të integruar në sistemin e Kosovës, përderisa e nënvizojnë faktin se integrimi do të iu ndihmonte në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

“Secili qytetar i Republikës së Kosovës duhet të jetë i integruar.”

(Burrë, 20-vjeçar, Bujanoc)



Në anën tjetër qëndrojnë ata që besojnë se integrimi i policisë dhe gjyqësorit nuk iu ka sjell asnjë dobi serbëve të Kosovës, dhe nuk i kontribuon sigurisë së tyre.

“Unë mendoj se për këta njerëz do të ishte më e sigurt që të jetonin atje (në komunat me shumicë serbe), sepse atje ekziston një zyrtar policor që punon për shtetin e Serbisë. Për shembull, nëpër shkolla. Aktualisht, ata punojnë për një shtet tjetër.” (Burrë, 29, Vrajë)



Ajo që duhet thënë është se një numër i konsiderueshëm i respondentëve mendonin se integrimi i policisë dhe gjyqësorit nuk ishte realizuar, dhe disa madje as që e kuptonin se

çfarë do të thotë integrimi. Për shembull, një respondent pyeti (duke iu referuar një veprimi të fundit të njësitit policor ROSU në veri të Kosovës):

“Nëse atje ishin policët serbë, pse atëherë e lejuan ROSU-në brenda? Ata duhet t’i kishin mbrojtur njerëzit nga ROSU.” (Burrë, 67-vjeçar, Novi Sad)



Të intervistuarit ishin paksa më të informuar për integrimin e policisë dhe gjyqësorit, krahasuar me pjesëmarrësit në fokus-grupe. Megjithatë, edhe ata ende mendonin se marrëveshjet dhe

rezultatet e tyre nuk po komunikohen si duhet, dhe se, si rrjedhojë, duhet të bëhen përpjekje të mëdha vetëm që të kuptohet se çfarë në fakt po ndodhë në terren.

“Policia, gjykatat dhe prokuroria, të gjitha janë integruar. Disa prej atyre që nuk u integruan e di sigurt që kanë ardhur në Serbi. Diçka ka ndodhur edhe në gjykatën e Vrajës - ose i ka marrë përsipër disa raste, ose diçka ngjashëm. Nuk e di saktësisht, ka aq shumë ngjarje, sa që e tëra momentalisht po i ngjanë një cirku. Në fund askush nuk di asgjë, prandaj unë mendoj se qëllimi edhe është shkaktimi i qëllimshëm i konfuzionit tek njerëzit.” (Aktiviste, Grua, Vrajë)



ASOCIACIONI I KOMUNAVE SERBE

Pas Marrëveshjes së Brukselit, më 25 gusht 2015 u nënshkrua edhe Marrëveshja për Parimet e Përgjithshme të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë (A/KSS). Marrëveshja përcakton bazën ligjore për themelimin e Asociacionit, objektivat, strukturën organizative, marrëdhëniet me autoritetet qendrore, kapacitetin ligjor dhe financimin e tij. Shumica e **respondentëve shqiptarë të Kosovës** nuk besonin në jetësimin e kësaj marrëveshjeje. Për të gjithë ata, kjo ishte një ide vërtetë e rrezikshme, që do të ndikonte drejtpërdrejt në sovranitetin e Kosovës dhe në jetën e përditshme të qytetarëve të saj. Po ashtu, asociacioni do të ishte një lloj kopje e Republika

Srpska's në Bosnje e Hercegovinë, për shkak se nuk kishte gjasa që Asociacioni të jetë vetëm një lloj OJQ-je – sikurse që ishte prezantuar. Për më tepër, ekzistonte frika për ndikimin që mund të ketë Asociacioni në të ardhmen edhe në funksionimin e brendshëm të Kosovës, ngase u perceptua si një plan i Beogradit për zgjerimin e ndikimit të tij politik në Kosovë. Shikuar nga brenda, asociacioni do ta dëmtonte lëvizjen e lirë të njerëzve nëpër Kosovë, ngase qytetarët kosovarë nuk do të mund të kalonin, udhëtonin dhe as të ndaleshin nëpër komunat me shumicë serbe. Për më tepër, ai do t'i shtonte edhe më shumë tensionet etnike, duke e bërë kështu situatën edhe më të keqe se sa që është tani.

Nga ana tjetër, do ta dëmtonte edhe vetë trashëgiminë kulturore të Kosovës.

“Çka do të ndodhte me qytetin antik të Ulpianës? Ai shtrihet mes Graçanicës, që është komunë me shumicë serbe dhe Prishtinës, që është kryeqytet i Kosovës?” (Grua, në të 50-at, Prizren)



Sipas tyre, nuk ka nevojë për një ndarje të tillë të brendshme, meqenëse serbët që jetojnë në Kosovë kanë jetë të mirë, dhe më nuk ka tensione etnike.

Reagimet në fokus-grupe dhe në anketimin online me **respodentë serbë nga Kosova** treguan se ekzistojnë mendime të kundërta lidhur me çështjen e themelimit eventual të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe (A/KSS). Përderisa të gjithë respodentët e kritikuan mos-themelimin e këtij entiteti deri më tani, përkundër faktit se ka kaluar shumë kohë e gjatë prej se Prishtina dhe Beogradi ishin dakorduar për një gjë të tillë, qëndrimet e tyre rreth natyrës, rolit eventual dhe rëndësisë së tij për komunitetin serb në Kosovë ndryshonin.

Më shumë se gjysma e respodentëve nënvizuan se themelimi i A/KSS do të kishte një rëndësi të madhe për komunitetin, por vetëm me kusht – që entiteti të kishte fuqi ekzekutive. Në të kundërtën, siç u tha nga grupi i respodentëve, interesat e këtij komuniteti nuk do të garantoheshin dhe as mbroheshin mjaftueshëm institucionalisht. Pa

një fuqi ekzekutive A/KSS do t'i përngjante një OJQ-je, në kuptimin e përmbushjes së autoritetit të tij potencial.

Ata që pohonin se A/KSS nuk do të siguronte mbrojtjen e të drejtave të komunitetit serb në Kosovë, pavarësisht asaj nëse ai do të kishte fuqi ekzekutive ose jo, konstatuan në vazhdimësi se ky entitet nuk paraqet as marrëveshjen dhe as modelin e duhur institucional për komunitetin. Të njëjtit grup i përkisnin edhe respodentët që vinin nga Shillova dhe Gorazhdeci, edhe pse këta u shprehën kundër formimit të A/KSS, për shkak se as popullata dhe as territoret e këtyre dy fshatrave nuk do të përfshiheshin brenda entitetit.

Të gjithë **respodentët nga Serbia** e dinin se A/KSS nuk është themeluar ende. Mendimi dominues mes respodentëve të përkatësisë etnike serbe ishte se Asociacioni duhet të themelohet dhe se ai do të ishte një model i mirë për mbrojtjen e të drejtave të serbëve në Kosovë. Disa nga respodentët boshnjakë nga fokus-grupet në Novi Pazar e kishin këtë mendim:

“A/KSS është i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të pakicave në Kosovë. Do të ishte mirë që edhe Serbia të rajonalizohet, dhe që rajoneve pastaj t’iu jepte një shkallë më të lartë të autonomisë.” (Burrë, rreth të20-ave, Novi Pazar)



Vetëm disa respodentët etnisë serbe mendonin se A/KSS nuk është ide e mirë. Njëri nga ata mendimin e vet e sqaroi në këtë mënyrë:

“Më mirë është që[A/KSS] të mos formohet fare në një klimë të tillë politike. Unë i njoh njerëzit që janë tani në pushtet në Mitrovicë. Mentaliteti dhe qëndrimi i atyre njerëzve paraqet një bindje absolute ndaj Beogradit. Ata s’kanë asnjë qëndrim. Me njerëz të tillë A/KSS nuk duket ide e mirë për momentin, të paktën për sa iu përket serbëve.” (Grua, 45, Beograd)



Një respondent nga Vraja (nga grupi i të rinjve) deklaroi se Republika Srpska duhet të jetë model për A/KSS-në e ardhshëm.

Nga ana tjetër, respondentët e përkatësisë etnike shqiptare, ose mendonin që A/KSS nuk duhet të themelohet fare, ose që ai duhet të formohet por pa kompetenca ekzekutive - si një ekuivalencë me Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi, një organ ky që ka mandat mbrojtjen e të drejtave

të kësaj pakice në fushat e kulturës, arsimit dhe informimit. Tutje, të gjithë respondentët shqiptarë u pajtuan se reciprociteti duhet të bëhet pjesë e të gjitha formave të negociatave. Kjo nënkupton se, në rast të themelimit të A/KSS në komunat me shumicë serbe në Kosovë, një organ ekuivalent duhet të themelohet edhe për shqiptarët që jetojnë në Luginë të Preshevës.

“Marrëveshja duhet të përfshijë edhe Luginën e Preshevës. Ajo që zbatohet për serbët në Kosovë duhet të zbatohet edhe për shqiptarët e këtushëm. Nëse themelohet A/KSS në Kosovë, atëherë një formë e tillë duhet të gjendet edhe për Luginën e Preshevës.” (Burrë, 30 vjeç, Bujanoc)

Të intervistuarit ishin të ndarë nëse dhe si duhet të themelohet A/KSS, për shkak se ishin të vetëdijshëm se kjo është një çështje tejet e ndjeshme. Veç kësaj, disa prej tyre mendonin

se tani nuk është momenti i duhur për implementimin e kësaj marrëveshjeje, ndonëse kjo do të ishte një gjë e mirë për komunitetin serb në Kosovë.

“Kur A/KSS u përmend për herë të parë, më tingëlloi si diçka vërtet e dobishme, si diçka që do të mund të bashkonte një komunitet i cili, me plot kuptimin e fjalës, është i shpërndarë në gjithë Kosovën. Mirëpo, sjellja e Republikës Serbe asokohe ishte aq e papërshtatshme, sa që i tmerroi të gjithë. Rrjedhimisht, për shkak të asaj sjelljeje qoftë edhe një mendim i vetëm për autonomi kulturore për serbët në Kosovë ishte i papranueshëm. Vendimmarrësit u tmerruan nga potenciali destruktiv i A/KSS, ky perceptim pastaj ndikoi edhe në implementim.” (Aktiviste, Grua, Novi Pazar)

Disa besonin se A/KSSpo përdoret qëllimisht për të bllokuar përparimin e mëtutjeshëm në çështjet kryesore që ende mbeten të pazgjidhura,

megjithëse, sipas tyre, është e qartë se Asociacioni nuk duhet të nënkuptojë asnjë lloj autonomie substanciale për serbët e Kosovës.

“Unë e di se nuk është implementuar, dhe A/KSS-në nuk e shoh si ndonjë lloj rajoni autonom për serbët e Kosovës. Madje, A/KSS as që është çështje kyçe, por besoj se qëllimisht është bërë çështje e madhe, në mënyrë që të na mbajë larg trajtimit të problemeve shumë më të rëndësishme për raportet mes nesh.” (Aktivist, Burrë, Kralejë)

4.4. PARAQITJA GRAFIKE E NIVELIT TË NJOHURIVE PËR MARRËVESHJET TEKNIKE

Tabela në vazhdim paraqet krahasimin e nivelit të informimit të tri grupeve të synuara nga studimi për marrëveshjet e arritura gjatë dialogut teknik të ndërmjetësuar nga BE-ja.

MARRËVESHJA	Target-grupi	Pak të informuar					Shumë të informuar					
LIRIA E LËVIZJES	Shqiptarë nga Kosova	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	Serbë nga Kosova	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	Shtetas të Serbisë	■	■	■	■	■	■					
LIBRAT E REGJISTRIT CIVIL	Shqiptarë nga Kosova	■	■	■	■	■	■					
	Serbë nga Kosova	■	■	■								
	Shtetas të Serbisë	■	■									
KADASTRI	Shqiptarë nga Kosova	■	■	■	■	■	■					
	Serbë nga Kosova	■	■	■								
	Shtetas të Serbisë	■										
DIPLOMAT UNIVERSITARE	Shqiptarë nga Kosova	■	■	■	■	■	■	■				
	Serbë nga Kosova	■	■	■	■	■						
	Shtetas të Serbisë	■	■	■	■	■	■					
VULAT DOGANORE	Shqiptarë nga Kosova	■	■	■	■	■	■					
	Serbë nga Kosova	■	■									
	Shtetas të Serbisë	■	■									
IBM	Shqiptarë nga Kosova	■	■	■								
	Serbë nga Kosova	■	■	■	■	■	■	■				
	Shtetas të Serbisë	■	■									
PËRFAQËSIMI DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL	Shqiptarë nga Kosova	■	■	■	■	■	■	■				
	Serbë nga Kosova	■	■									
	Shtetas të Serbisë	■	■	■	■	■						

5. PËRSHTYPJET E PJESËMARRËSVE LIDHUR ME TË ARDHMEN E DIALOGUT

Implementimi i përgjithshëm i marrëveshjeve teknike u vlerësua negativisht nga shumica e fokus-grupeve, ngaqë respondentët ishin skeptikë rreth përfitimeve që dolën nga implementimi i marrëveshjeve. Pavarësisht prejardhjes ose origjinës së tyre, te shumica e respondentëve vërehej një ndjenjë shqetësimi, skepticizmi dhe pesimizmi. Anketimi online tregoi vlerësimin se ndikimi i përgjithshëm i implementimit të marrëveshjeve teknike ishte negativ, pa asnjë ndikim të drejtpërdrejtë (pozitiv) në jetën personale të respondentëve.

Për më tepër, respondentët pohuan se qytetarët e Kosovës nuk përfituan asgjë nga procesi i implementimit të marrëveshjeve teknike, përderisa një pjesë e tyre deklaroi se politikanët ishin të vetmit që e shfrytëzuan këtë proces për ta promovuar veten. Si pasojë e këtyre qëndrimeve, të gjithë respondentët shprehën një nivel të lartë mosbesimi rreth të ardhmes së dialogut.

Shkaqet/shqetësimet si më poshtë u përmendën si pengesat kryesore për të ardhmen e dialogut:

- **Mungesa e transparencës mbi procesin e implementimit,**
- **Papërgjegjësia dhe paaftësia e palëve relevante për implementimin e marrëveshjeve,**
- **Josinqeriteti dhe mungesa e vullnetit të liderëve politik që të angazhohen në vazhdimin e dialogut,**
- **Mungesa e shumë çështjeve të rëndësishme, që palët nuk janë të gatshme t'i trajtojnë,**
- **Akterët ndërkombëtarë hezitojnë që dialogun Kosovë-Serbi ta lehtësojnë më aktivisht, dhe**
- **Mosbesimi i shumë përhapur në rezultate pozitive.**

Të anketuarit shqiptarë të Kosovës besojnë se dialogu është vetëm në interes të Serbisë, meqenëse ai i ndihmon avancimit të saj në rrugën e integrimit në BE, ndërkohë që Kosova ende po lufton që të përfitojë njohjen e saj të plotë nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Për disa prej tyre, me vetë faktin që Serbia ka pranuar që të ulet me Kosovën në tryezë të bisedimeve ajo de facto e ka njohur atë si shtet; prandaj, siç thonë ata, edhe procesi i deritanishëm ka qenë “në interesin tonë më të mirë.” Për shumicën e respondentëve “fundi i lojës” mbetet i pasigurt dhe i panjohur, prandaj ky edhe është shkak se përse akterët kryesor mbajnë të fshehta përmbytjen dhe qëllimin e marrëveshjeve të arritura. Duket sikur vetëm elitat politike në pushtet mund të dijnë se çfarë mund të sjellë “finalja e madhe” (përfshirë këtu marrëveshjen eventuale për normalizim e plotë të marrëdhënieve).

Përderisa disa respondentë mendonin se ndërmjetësuesi duhet të ndërrohet, një numër i pjesëmarrësve nënvizuan se dialogu duhet të mbetet brenda kompetencave të BE-së. Një numër i respondentëve, nga pothuajse të gjitha fokus-grupet, nënvizuan se dialogu mes Serbisë dhe Kosovës nuk do të duhej të kishte ndërmjetësues fare. Ata besonin se mosmarrëveshjet do të zgjidheshin më lehtë nëse nuk do të kishte ndërmjetësues, sepse ndërmjetësuesit vetëm sa po e ndërlikojnë pa nevojë gjithë procesin. Respondentët me etni shqiptare besojnë se kusht kryesor për vazhdimin e suksesshëm të dialogut teknik të ndërmjetësuar nga BE-ja është njohja e ndërsjellë, respektivisht njohja e shtetësisë së Kosovës nga Serbia. Shumica e respondentëve besojnë se në dialog duhet të marrin pjesë edhe shumë akterë të tjerë nga shoqëria, e jo vetëm politikanët e nivelit të lartë, meqenëse procesi vazhdon të mbetet tejet i centralizuar dhe i mbyllur për publikun.

“... edhe Serbia edhe Kosova aspirojnë që të hyjnë në BE, prandaj edhe duhet të gjendet një gjuhë e përbashkët. Pra, nëse qëllim është BE-ja, atëherë duhet të fillojmë prej aty.” (Grua, 20, Beograd)



6. PËRFUNDIME TË PËRGJITHSHME

Këto përfundime ndihmojnë në kuptimin më të mirë të përshtypjeve të qytetarëve të zakonshëm, dhe me prejardhje të ndryshme, për procesin e dialogut, si dhe në projektimin sa më të suksesshëm të çfarëdo ndërhyrjeje të mundshme që mund të ndodhë në të ardhmen.

Thënë në përgjithësi, pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë janë të pakënaqur me procesin e implementimit të marrëveshjeve teknike, por edhe me vetë dialogun. Ata mendojnë se nuk janë informuar fare për përmbajtjen e as për procesin e implementimit të disa marrëveshjeve që i konsiderojnë të rëndësishme, si Marrëveshja për Energji, ajo për Telekomunikacion, për Diploma Universitare, e të tjera.

Ndikimi i politikës ditore në retorikën politike dhe sociale ka ulur rëndësinë e procesit të implementimit të marrëveshjeve teknike, një dukuri kjo që është thelluar edhe më tepër nga palët relevante të interesit, të cilat procesin e negocimit e kanë keqpërdorur për qëllime të vetë-promovimit.

Mungesa e një raportimi transparent të Beogradit dhe Prishtinës për procesin e dialogut dhe për pasojat e tij është cilësuar si një prej pengesave kryesore për informimin e qytetarëve për temat e trajtuara në këtë studim.

Kritikat cilësore të këtij studimi tregojnë se shumica e përshtypjeve lidhur me dialogun ndërlidhen ngushtë me luftën e vitit 1999. Kur u pyetën për procesin e deritanishëm të dialogut, pjesëmarrësit theksuan se dialogu nuk i ka prekur fare çështjet urgjente të cilat do të duhej trajtuar, siç janë krimet e luftës, personat e zhdukur apo kërkimfaljen. Për shumicën dërrmuese të pjesëmarrësve në studim, këto ishin tema që do të duhej të përfshiheshin, sepse kanë rëndësi më të madhe se sa marrëveshjet e arritura përmes dialogut teknik.

Shumica e pjesëmarrësve besojnë se – nëse marrëveshjet do të zbatoheshin - kjo do të sillte përfitime të prekshme për qytetarët.

“Shumica e marrëveshjeve mbetën vetëm në letër. [...] Qytetarët nuk ndiejnë asnjë përfitim.”

(Burrë, 30+, Bujanoc)



Shumica e respondentëve nga Serbia pohuan se nuk e dinin nëse marrëveshjet e dialogut teknik të ndërmjetësuar nga BE-ja i kontribuojnë një jete më të mirë për shqiptarët e Kosovës. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se shumica e respondentëve që vinin nga qytetet me një përqindje të lartë të popullatës së zhvendosur (Kraleva dhe Kragujevci) shprehën pakënaqësi të konsiderueshme ndaj serbëve të Kosovës, të cilët u zhvendosën nëpër qytetet e tyre - para ose pas luftës në Kosovë. Këta respondentë

besojnë se personat e zhvendosur nga Kosova gëzojnë trajtim të privilegjuar në Serbi, gjë që ndikon në diskriminimin e “vëndorëve”. Po ashtu ata theksuan se serbët nga Kosova marrin ndihma financiare nga shteti, dhe kanë një trajtim të privilegjuar për punësim. Paralelisht, disa nga respondentët i potencuan edhe dallimet e pretenduara kulturore mes serbëve lokal dhe atyre që vijnë nga Kosova.

Për nxitjen e tensioneve etnike, por edhe për nxitje të frikës e urrejtjes, disa responentë i fajësuan edhe mediat - të cilat ata konsiderojnë se kontrollohen nga elitat politike. Për më tepër, një numër i konsiderueshëm i responentëve deklaruan se nga niveli aktual i dialogut përfitojnë vetëm politikanët në pushtet dhe kriminelët, të cilët përfitojnë nga vakumi ligjor dhe nga gjendja e jashtëzakonshme - de facto. Mirëpo, të gjithë responentët, qoftë ata të fokus-grupeve apo të intervistuarit, besojnë se dialogu është mënyra e vetme që të ecet përpara, prandaj në vend se të braktiset, ai vetëm duhet të përmirësohet.

Për sa i përket dallimeve mes grupeve etnike, shumica dërrmuese e responentëve serbë e kundërshtuan idenë e Kosovës së pavarur,

përderisa të gjithë shqiptarët etnikë Kosovën e shohin si shtet të pavarur. Ky dallim i strukturon mendimet dhe këndvështrimet e tyre edhe për të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me Kosovën. Po ashtu, serbët dhe shqiptarët kanë këndvështrime të kundërta edhe për telekomunikacionin e, deri diku, edhe për lirinë e lëvizjes (lidhur me atë se kush përfiton prej saj). Një nivel i caktuar mospajtimesh personale u vërejt edhe tek disa pjesëmarrës në fokus-grupe (nga Serbia), të cilët shprehnin dy këndvështrime të kundërta mes vete: e para, ishte se *“ne duhet ta pranojmë realitetin”* dhe e dyta se *“unë e shoh Kosovën si pjesë të Serbisë”*. Me sa duket, kur bëhet fjalë për Kosovën, nacionalizmi është (deri diku) njëllor karakteristike e pranishme në të gjitha gjeneratat.

7. TË GJETURAT KRYESORE NGA RAPORTI

Pas analizimit të rezultateve të studimit, në vazhdim janë radhitur gjetjet kryesore:

- Implementimi i përgjithshëm i të gjitha marrëveshjeve teknike është vlerësuar negativisht nga shumica e grupeve të trajtuara, ndërkohë që responentët ishin skeptikë edhe për përfitimet që sjell implementimi i marrëveshjeve;
- Pjesa dërrmuese e responentëve nuk kishin njohuri për përmbajtjen e marrëveshjeve teknike. Ata i dinin disa çështje të caktuara, por nuk kishin njohuri për marrëveshjet që kishin lidhje me këto çështje. Të intervistuarit ishin më mirë të informuar, megjithëse e pranonin se kishin disa paqartësi për vet procesin dhe rezultatet e tij;
- Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes është një prej marrëveshjeve të pakta për të cilat shumica e pjesëmarrësve ishin mirë të informuar dhe kishin përvoja personale nga implementimi i saj;
- Njohuritë e përgjithshme të grupeve të trajtuara për marrëveshjet teknike ishin në nivel mesatar, nëse kihet parasysh prejardhja e ndryshme e pjesëmarrësve në fokus-grupe. Po të krahasohen, del se gjeneratat më në moshë (31+) janë përgjithësisht më të informuara lidhur me implementimin e marrëveshjeve teknike se sa gjeneratat më të reja;
- Sa i përket dallimeve mes grupeve etnike, shumica e responentëve serbë e kundërshtojnë idenë e Kosovës së pavarur, përderisa të gjithë shqiptarët etnikë Kosovën e shohin si shtet të pavarur. Qëndrimet e shumicës së serbëve etnikë ndaj Kosovës duket se ndikohen nga diskurset nacionaliste për Kosovën – qoftë edhe atëherë kur disa prej tyre deklarativisht distancohen nga nacionalizmi serb;
- Shumica e responentëve besojnë se dialogu i deritanishëm nuk ka qenë i dobishëm për qytetarët. Një numër i vogël i tyre besojnë se disa gjëra janë përmirësuar (liria e lëvizjes, telekomunikacioni, etj.), ndonëse po të njëjtit e pranojnë se përmirësimet janë tejet të vogla. Pavarësisht përkatësisë etnike, arsimimit ose moshës së tyre, të gjithë responentët pajtohen se nga dialogu – në formën se si është zhvilluar deri më tani – përfitojnë vetëm elitat, politike ose të tjera.

8. REKOMANDIMET

Bazuar në përfundimet, rezultatet e studimit dhe gjetjet e lartpërmendura, rekomandimet e mëposhtme duhet të merren parasysh nga palët relevante të interesit:

- Qeveria e Kosovës dhe e Serbisë duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për informimin e qytetarëve të tyre rreth rezultateve të dialogut teknik të ndërmjetësuar nga BE-ja dhe rreth implementimit të marrëveshjeve teknike –nëpërmjet një gjuhe lehtësisht të kuptueshme për të gjithë qytetarët;
- Përfundimet, raportet dhe diskutimet rreth procesit të implementimit të marrëveshjeve teknike duhet të jenë më transparente dhe më të shpeshta. Qeveritë duhet të mbajnë takime dhe diskutime më të shpeshta me qytetarë, për marrëveshjet dhe për vetë dialogun.
- Procesi i implementimit nuk duhet të përdoret për qëllime të promovimit të akterëve politikë, qofshin ata në Kosovë apo në Serbi;
- Marrëveshjet e paimplementuara teknike duhet të rishikohen brenda kornizës së bisedimeve të dialogut teknik të ndërmjetësuar nga BE-ja, ose të zëvendësohen me më të efektshme;
- Ekspertët duhet të kenë një rol më të madh në procesin e implementimit dhe dialogut, në vend se kjo të bëhet vetëm nga ana e përfaqësuesve politik të Prishtinës dhe Beogradit të përfshirë në proces;
- Popullata lokale duhet të përfshihet në procesin e implementimit të marrëveshjeve teknike, sepse kjo gjë do të ketë një efekt të dyfishtë: pjesëmarrjen e njerëzve të zakonshëm dhe një nivel më të lartë të njohurive me përmbajtjen e marrëveshjeve;
- Mediat duhet të kenë një rol më të madh në monitorimin e procesit të implementimit dhe, si rrjedhojë, në informimin e popullatës për rezultatet;
- Bashkimi Evropian, si ndërmjetësuesi procesit të implementimit, duhet të sigurojë një implementim transparent dhe adekuat të të gjitha marrëveshjeve teknike, por edhe të luaj një rol më të madh në monitorimin e angazhimit të Prishtinës dhe Beogradit në këtë çështje;
- BE duhet të ketë një mekanizëm më të mirë për detyrimin e Serbisë dhe Kosovës që të implementojnë marrëveshjet ekzistuese;
- Ekziston nevoja për një ristrukturim të dialogut, në mënyrë që të gjitha aktivitetet dhe përpjekjet të vlerësohen në bazë të përfitimeve të prekshme nga ana e qytetarëve;
- Duhet krijuar dhe shtyre përpara një retorikë tërë – e cila do të fokusohet në problemet dhe interesat e përbashkëta që i kanë dhe i ndajnë serbët dhe shqiptarët.

Ky studim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij studimi është përgjegjësie vetme e *Grupit për Politika dhe Avokim Kosovë-Serbi*, dhe i njëjti nuk mund të kuptohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.

SHTOJCAT

1. PYETËSORI PËR FOKUS-GRUPE

Pyetjet hyrëse

- A jeni i interesuar për temat që ndërlidhen me dialogun e Brukselit? A i ndiqni lajmet që kanë të bëjnë me dialogun e Brukselit dhe me marrëveshjet teknike të nënshkruara e të implementuara nga Beogradi dhe Prishtina?
- A e dini se çfarë është arritur deri më tani në kuadër të dialogut teknik mes Beogradit dhe Prishtinës?
- A ka ndikuar implementimi i përgjithshëm i marrëveshjeve teknike në jetën tuaj të përditshme në Kosovë? Nëse po, a do ta kishit mirësinë të na tregonit se në ç'mënyrë?

Rezultatet praktike të marrëveshjeve teknike; Një hap përpara, apo prapa?

- Sipas mendimit tuaj, a është implementuar plotësisht marrëveshja për liri të lëvizjes (lejimi i lëvizjes së lirë të njerëzve mes Kosovës dhe Serbisë vetëm me letërnjoftime personale)? Si ka ndikuar implementimi i kësaj marrëveshjeje tek ju personalisht?
- Si do ta vlerësonit implementimin e marrëveshjes për targa të automjeteve? A ishte implementimi i kësaj marrëveshjeje i dobishëm për ju personalisht për sa i përket lëvizjes së lirë/udhëtimit brenda Kosovës apo Serbisë? Ju lutemi që të elaboroni dhe të jepni ndonjë shembull nga përvoja juaj.
- Njëjtë, a ka qenë implementimi i marrëveshjes për sigurimin e automjeteve i dobishëm për ju, për sa i përket lëvizjes së lirë/udhëtimit? Ju lutemi që ta elaboroni dhe të jepni ndonjë shembull nga përvoja juaj.
- A mendoni se marrëveshja për lëvizjen e lirë të mallrave (në përputhje me CEFTA-në) i ka ndihmuar komunitetit serb (ose juve personalisht) për zhvillimin/lehtësimin e aktiviteteve ekonomike në Kosovë? A ka pasur ajo ndonjë ndikim në shprehjet tuaja të blerjes ose në biznesin tuaj personal? Nëse po/jo, ju lutemi që të tregoni përse.
- Në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave, a keni njohuri për marrëveshjet për mbledhjen e të hyrave doganore dhe për njohjen e ndërsjellë të certifikatave për mallra të rrezikshme? Nëse po, ju lutemi që t'i elaboroni.
- A keni njohuri për marrëveshjen e bashkëpunimit mes dy odave ekonomike? Nëse po, ju lutemi që të jepni mendimin tuaj lidhur me këtë lloj bashkëpunimi.
- Si do ta vlerësonit punën e Fondit për Zhvillimin e veriut të Kosovës, i cili është krijuar si rrjedhojë e marrëveshjes Beograd-Prishtinë? A keni informacione për aktivitetet dhe përfitimet nga ai për banorët lokalë?
- A e ka lehtësuar implementimi i marrëveshjes për telekomunikacion përdorimin e telefonisë fikse dhe asaj mobile brenda komunitetit serb në Kosovë? A ka qenë themelimi i ndërmarjes MTS d.o.o. i dobishëm në kuptimin praktik? A ka ndikuar kjo marrëveshje në mënyrën e përdorimit të kanaleve të (tele)komunikimit? Ju lutemi të na sillni ndonjë shembull nga jeta e përditshme.

- A jeni të informuar për punën e zyrave ndërlidhëse në Beograd dhe Prishtinë, të cilat u krijuan pas nënshkrimit të marrëveshjes për zyrat ndërlidhëse? Nëse po, ju lutemi të na eleboroni lidhur me këtë çështje.
- A keni njohuri për marrëveshjen për njohjen e ndërsjellë të diplomave? Nëse po, a do ta ndanit mendimin tuaj me ne lidhur me këtë temë?
- Si do ta vlerësonit implementimin e Marrëveshjes për Menaxhim të Integruar të Kufirit (IBM)? A keni pasur ndonjë përvojë personale (pozitive/negative) gjatë kalimit të IBM-it? Nëse po, ju lutemi ta elaboroni këtë gjë.
- Në këtë kontekst, si do ta vlerësonit marrëveshjen ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës për vulat doganore?
- A keni njohuri për marrëveshjen për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal? Nëse po, si do ta vlerësonit atë?
- Si do ta vlerësonit marrëveshjen për energji? A keni njohuri për të?
- A mendoni se revitalizimi i urës kryesore në Mitrovicë, që u dakordua në Bruksel, do ta përmirësojë jetën e përditshme dhe raportet multi-etnike në të dy pjesët e Mitrovicës? Nëse po/jo, ju lutemi që të tregoni përse. (Kjo pyetje do të parashtrohet ekskluzivisht vetëm për të intervistuarit në dy fokus-grupet që do të mbahen në Mitrovicën e Veriut)

Çështjet me rëndësi vitale për komunitetin serb në Kosovë

- A mendoni se themelimi i Asociacionit/Bashkësisë të Komunave me Shumicë Serbe do ta përmirësonte pozitën e komunitetit serb në Kosovë? A mendoni se ai do ta përmirësonte jetën tuaj personale? Nëse po/jo, ju lutemi të tregoni dhe elaboroni përse.
- Si do ta përshkruanit ndikimin e implementimit të marrëveshjes për gjyqësorin në komunitetin serb në Kosovë? A keni pasur ndonjë përvojë me sistemin (e integruar) gjyqësor? Ju lutemi që ta elaboroni përgjigjen në këto pyetje dhe të jepni ndonjë shembull nga jeta e përditshme.
- Si do ta vlerësonit implementimin e marrëveshjes për policinë (integrimin e saj)? Si do ta vlerësonit rolin e saj brenda komunitetit tuaj?
- Cili është këndvështrimi juaj për integrimin e personelit të ish-Mbrojtjes Civile? A e ka ndryshuar kjo gjë nivelin e sigurisë në komunitetin/lagjen tuaj?

2. PYETËSORI PËR ANKETIMIN ONLINE

- A jeni i interesuar për temat që kanë të bëjnë me dialogun e Brukselit?
- A mund të numëroni të paktën tri marrëveshje të arritura në kuadër të dialogut teknik?
- Si jeni informuar për dialogun teknik dhe marrëveshjet?
- A mendoni se qeveria i ka informuar qytetarët në mënyrë të efektshme për rezultatet e dialogut teknik, dhe se ka qenë e rregullt në implementimin e marrëveshjeve?
- A i ka prekur dialogu çështjet urgjente me të cilat përballen qytetarët, në raportin Kosovë-Serbi?
- A e keni përdorë personalisht mundësinë e udhëtimit në Serbi pas nënshkrimit të marrëveshjes për liri të lëvizjes?
- Si do ta vlerësonit implementimin e marrëveshjes për IBM-in? A keni pasur ndonjë përvojë personale pozitive/negative gjatë kalimit të pikës kufitare? Nëse po/jo ju lutemi që ta elaboroni.
- A mendoni se revitalizimi i urës kryesore në Mitrovicë, që u dakordua në Bruksel, do ta përmirësojë jetën e përditshme dhe raportet multietnike në të dy pjesët e Mitrovicës? Nëse po/jo, ju lutemi që të tregoni përse.
- A keni njohuri për Marrëveshjen për Energji dhe për fazat e implementimit të saj? Cilat aspekte të energjisë janë të rëndësishme për jetën e përditshme të qytetarëve? Ju lutemi që të elaboroni rreth kësaj çështjeje.
- A keni njohuri për Marrëveshjen për Telekomin? Cilat aspekte të saj janë të rëndësishme për jetën e përditshme të qytetarëve?
- A e ka lehtësuar implementimi i marrëveshjes për telekomunikacion përdorimin e telefonisë fikse dhe asaj mobile për komunitetin serb në Kosovë? A ka qenë i dobishëm themelimi i ndër-marrjes MTS d.o.o. në kuptimin praktik? A ka ndikuar kjo marrëveshje në mënyrën e përdorimit të kanaleve të (tele)komunikimit? Ju lutemi që të jepni ndonjë shembull nga jeta e përditshme.
- A mendoni se themelimi i Asociacionit/Bashkësisë të Komunave me Shumicë Serbe do ta përmirësonte pozitën e komunitetit serb në Kosovë? A mendoni se do ta përmirësonte jetën tuaj personale? Nëse po/jo, ju lutemi të tregoni dhe elaboroni përse.
- A ka ndikuar implementimi i përgjithshëm i marrëveshjeve teknike në jetën tuaj të përditshme në Kosovë? Nëse po, a do ta kishit mirësinë të na tregonit përse?
- Cila prej marrëveshjeve u tregua më e suksesshme në implementim, dhe cilën e konsideroni të dështuar plotësisht?
- Kush po përfiton më shumë nga dialogu teknik? A është dialogu teknik i dobishëm për qytetarët në Serbi dhe Kosovë? Nëse po, cilat janë përfitimet? Nëse mendoni se dialogu nuk është i dobishëm, cila është arsyeja për këtë?

Grupi për Politika dhe Avokim Kosovë-Serbi (KSPAG) është një konsorcium i OJQ-ve dhe instituteve hulumtuese, të cilat besojnë fuqishëm në procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Grupi u bashkua me një qëllim të përbashkët për të ripërtërirë mbështetjen për dialogun në kohën kur interesi i shumë akterëve në të dy shoqëritë kishte pësuar rënie. Përpjekjet tona individuale dhe të përbashkëta kanë për qëllim të krijojnë qasje dhe ide të reja për të mbështetur dialogun dhe për të përmisuar pikëpamjet dhe narracionin publik. Aktivitetet e KSPAG-ut kanë për qëllim të njoftojnë qytetarët dhe akterët tjerë me saktë për procesin e dialogut, rrisin mbështetjen për të krijuar ide të reja për procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.

Grupin për Politika dhe Avokim Kosovë-Serbi përbëhet nga Balkans Policy Research Group (BPRG), Demokraci për Zhvillim (D4D), Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), dhe NGO Aktiv nga Kosova dhe Belgrade Fund for Political Excellence (BFPE), Belgrade Center for Security Policy (BCSP), The Lawyers' Committee For Human Rights (YUCOM), European Movement Serbia (EMinS) nga Serbia përbëjnë Grupin për Politika dhe Avokim Kosovë-Serbi.



**Për më shumë
rreth nesh vizitoni
uebfaqen tonë:**

www.k-s-pag.org